

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7560 E premte 15 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Marrëveshja historike midis Greqisë dhe Maqedonisë për zgjidhjen e problemit 27-vjeçar për emrin e ri të Maqedonisë është shpresëdhënëse për ruajtjen e stabilitetit...
Vijon në faqen 20

Nga RUDINA HAJDARI

Real-politikë mbi çeljen e negociatave



Opinion **Ditës**

Në fillim të muajit qershor, për shkak të tam-tameve që shkaktoi krijimi i qeverisë së parë populiste në Romë, dukej se pakkush po shihte ndryshimin tjetër...
Vijon në faqen 21

Nga dr. JORGJI KOTE

Ndryshime premtuese në Madrid



Ndrenika: Të gënjyen me 30 milionë eurot

Aktorët me Veliain: Jo Teatër me PPP. Reshat Arbana: Kullat do na bien mbi kokë

Drejtorët e emëruar nga qeveria mbrojnë shembjen. Kryebashkiaku: Do të negociojmë

Nga FATMIRA NIKOLLI

Pas katër muajsh protestë për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, artistët janë pritur dje në një dëgjese nga kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliain. Në hyrje të hotelit ku do mbahej takimi, ai u qëllua me vezë nga të rinjtë e FRPD-së, por asnjë prej tyre nuk e kapi...
Në faqen 18-19

"OPEN DATA" PUBLIKON DEKLARATAT, PRONAT DHE LLOGARITE E "RAMA 2"

PASURIA E QEVERISE, SA FITON RAMA NGA PIKTURAT

Ministri i Brendshëm jeton me pagën dhe shpërblimet. Senida Mesi, 14 llogari bankare. Kryeministri, 3.8 milionë lekë nga krijimtaria gjatë vitit 2017



(Në foto) Kryeministri Edi Rama, Mesi, Xhafaj, Klosi, Peleshi, Nikolla, Gjiku, Ahmetaj, Gjonaj, Bushati, Kumbaro
Në faqen 5

INTERVISTA

Jamarbër Mallezi: PD është më mirë në opozitë se të përlyhet në korrupsion
Në faqen 4

KRIMI NE FAMILJE

Vrasja e dyfishtë, i riu, policëve: Do të qëllloja edhe vëllain dhe dajën
Në faqen 10

INTERVISTA

Lejet e qëndrimit në Greqi, eksperti: Si do të ndryshojnë tarifat dhe gjokat
Në faqen 8

FUTBOLL

Botërori rus nis me "manita", sot supersfida Spanjë-Portugali
Në faqen 22

FLET EKSPERTI



Artur Sulçe: Rregullat e reja për shitblerjen e automjeteve
Në faqen 7

Vendimi i qeverisë/ Përfitues nga rritja me 2.8% edhe ata që u nisën pas 1 korrikut

Pensionistët, kategoritë që marrin kompensim

Paratë për faturën e dritave dhe luhatjet e çmimit të bukës, sa është fondi

Nga VOLTIZA DURO

Pas datës 1 korrik të këtij viti, rreth 665 mijë pensionistë në vendin tonë do të përfitojnë rritje pensioni me 2.8% sipas vendimit më të fundit të qeverisë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e plotë të Këshillit



të Ministrave sipas të cilit do të përfitojnë rritje të masës së pensionit disa lloj kategorish të pensionistëve. Kështu nga indeksimi do të preken edhe pensionet që do të caktohen nga data 1 korrik 2018-të. "Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1...
Në faqen 9

INTEGRIMI REAGIMET

Komisioneri i BE për Zgjerimin: Reforma në gjyqësor është në lëvizje të plotë

Hahn: Shqipëria ka përmbushur kërkesat, të mbajmë premtimin

"I bindur se Franca e Holanda do shohin 'gotën gjysmë plot'"

Komisioneri i BE-së, Johan Hahn, në një intervistë për "Der Standard" shprehet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së emrit dhe e quan dritë të gjelbër për çeljen e negociatave me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Në një pjesë të intervistës së publikuar nga kryeministri Edi Rama, Hahn thekson se shprehet që Franca dhe Holanda ta shohin 'gotën gjysmë plot'. "Për momentin ka një trazirë nëpër rajon. Shkaku ishte strategjia jonë e zgjerimit, e cila hap një perspektivë për të gjitha shtetet. Në Kosovë ka pasur rati-fikimin e papranueshëm të marrëveshjes së kufirit me Malin e Zi. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Bullgaria kanë nënshkruar një marrëveshje miqësie dhe ka gjithashtu negociata të hapura midis Greqisë dhe Shqipërisë. Procesi i shqyrtimit gjyqësor në Shqipëri është në lëvizje të plotë. Reforma gjyqësore është një prioritet në Shqipëri", u shpreh Hahn. "Pra, nga këndvështrimi ynë, Shqipëria ka përmbushur kërkesat për të filluar procesin e shqyrtimit. Bazuar në këtë, ju mund të bëni një analizë për të parë kriteret për hapjen e kapitujve. Jam i bindur se Shqipëria, pas vendimit maqedonas, mund të bëjë të njëjtën gjë. Mundësia për reforma është më e fortë gjatë negociatave. Unë jam i bindur se Franca dhe Holanda do të shohin gjithashtu 'gotën gjysmë plot'. Besueshmëria jonë është pjesë e sistemit tonë të vlerave. Nëse bëjmë një premtim dhe pala tjetër plotëson kërkesat, atëherë ne duhet të pajtohemi. Nëse kjo nuk do të ndodhë, kjo do të prekte ven-

det e tjera në rajon", theksoi komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn.



Komisioneri i BE-së, Johan Hahn

det e tjera në rajon", theksoi komisioneri i BE-së për Zgjerimin, Johannes Hahn.

Ndërkohë, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas mbështet fuqimisht hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian, sipas "dereuters.com". "Mbështesim fuqimisht hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë për në Bashkimin Europian, siç edhe Komisioni Europian i ka rekomanduar", - deklaroi Maas gjatë një fjalimi në Berlin.

Maas kërkoi edhe një rol më të besueshëm të Europës në botë, duke bërë thirrje për reforma me ndikim, sidomos në fushën ekonomike dhe të monetare. "Europa duhet t'i tejkalojë ndarjet e viteve të kaluara", - theksoi Maas.



Parlamenti Europian

MINISTRI I JASHTËM GJERMAN

"Mbështesim fuqimisht hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë dhe Maqedonisë për në Bashkimin Europian, siç edhe Komisioni Europian i ka rekomanduar", - deklaroi Maas gjatë një fjalimi në Berlin.



Bushati: Anëtarësimi në BE, jo destinacion final, por proces i brendshëm reformimi

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati shtroi dje një "Mdarkë iftari për turpin diplomatik në Tiranë. Kreu i diplomacisë shqiptare, duke iu referuar shprehjes së Shën Agustinit "bamiçësia nuk mund ta zëvendësojë drejtësinë e munguar", nënvizoi se edhe përpjekja e qeverisë shqiptare për modernizimin e shoqërisë duke vijuar drejt anëtarësimit në BE - jo si destinacion final, por si proces i brendshëm reformimi, është shembull i rifillimit të një rrugëtimi të lënë në mes. Bushati theksoi në nisje të iftarit se muaji i Ramazanit është një nga momentet më të shenjtë të kalendarit vjetor të myslimanëve dhe një çast i rëndësishëm për të gjithë shqiptarët, të cilët para Zotit kanë qëndruar gjithnjë bashkë dhe të pandarë. Ai vuri në dukje se veçoria shqiptare e tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare ka lënë mbresa edhe të të huajt që kanë vizituar vendin tonë. "Por - shtoi ai - nuk mund të krenohemi vetëm me historinë e të parëve tanë". Bushati iu përgjigj atyre që thonë se shqiptarët janë të pafe, se nuk janë të aftë të thellohen në një besim të caktuar fetar. "Në Shqipëri, tradita jonë e ka për zakon që darka e Iftarit të ndahet me njerëz të feve e besimeve të tjera. Jo për sy e faqe, por sepse ndarja e bukës merr kuptim vetëm kur ajo ndahet me të gjithë. Iftari te ne nënkupton Iftarin ndërfaqetar, ku të pranishëm janë myslimanë, katolikë, ortodoksë, protestantë dhe njerëz të cilët besojnë tek e mira", tha ministri.

Ballat: Kemi shumë për të bërë, por i përkasim Europës

Lange: Gjermania mbështet hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE-në

Kryetari i grupit par Klamantar socialist, Taulant Balla priti dje në një takim sekretarin e Shtetit në Ministrinë Federale të Drejtësisë dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, Christian Lange dhe delegacionin që e shoqëron, ku dhe mori rikonfirmimin e mbështetjes së Gjermanisë për hapjen e negociatave të Shqipërisë me BE. "Jemi në një moment historik për Shqipërinë, në raport me perspektivën tonë të anëtarësimit në familjen europiane, ku natyrshëm ne i përkasim në çdo ditë të jetës sonë Bashkimin Europian, edhe pse kemi ende shumë punë për t'u bërë vend anëtar. Gjermania ka asistuar hartimin e reformës në drejtësi dhe po mbështet plotësisht implementimin e saj. Procesi i vetingut po ecën sipas pritshmërive", - u shpreh Balla. Më tej, Bal-



la e informoi sekretarin federal Lange se KPK deri tani ka shortuar dhe ka filluar hetimin administrativ për dhjetëra çështje, ndërkohë që çdo javë ka vendime për gjyqtarë apo prokurorë që kalojnë në sitën e vetingut. "Përgjatë këtyre 30 viteve, Gjermania e ka mbështetur Shqipërinë me më shumë se 1 miliard euro direkt dhe po kaq indirekt. Do të dëshiroja të vlerësoja rolin e zyrës së

Kfw dhe GIZ. Për ne janë shumë të rëndësishëm edhe si mbështetës, edhe si partnerë, që janë shumë aktivë në koordinimin e ndihmës së huaj duke marrë rolin e donatorit kryesor bilateral në shumë sektorë të zhvillimit të ekonomisë, duke përfshirë sektorin e energjisë, infrastrukturës ujore, arsimit dhe formimit profesional etj.", - u shpreh ai. Ndërsa, sekretari i Shtetit në Ministrinë Federale të Drejtësisë dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, Christian Lange u shpreh se që nga vizita e tij e kaluar në Tiranë, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm dhe të dukshëm përpara në rrugën e saj europiane. "Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Shqipërinë në këtë rrugë", - theksoi Christian Lange.

Ministri i Jashtëm shtroi iftar për trupin diplomatik



Presidenti kërkon plotësimin sa më shpejt të vakancës në Gjykatën Kushtetuese

Pakti me Greqinë, Ilir Meta: Pres informacione më të plota e serioze

"Me Ramën diskutuam për finalizimin sipas Kushtetutës"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta tha dje, se pret informacione më të plota e serioze nga Ministria e Jashtme lidhur me marrëveshjen për detin me Greqinë. Një ditë pas takimit me kryeministrin Edi Rama, Meta sqaroi për gazetarët: "Aktualisht jemi në një proces për të marrë vendime të mëtejshme, pasi Institucioni i Presidentit ka kërkuar dhe pret informacione edhe më të plota nga Ministria e Punëve të Jashtme, informacione këto që duhet të vijnë sipas standardeve më serioze që meriten rëndësia e kësaj çështjeje".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

mënyrën më transparente më të përgjegjshme pasi është një çështje në interes publik, është një çështje në interes kombëtar, por padyshim që është edhe një çështje që ka kontributin e vet në gjithë rolin dhe angazhimin e Shqipërisë si një vend që punon për fqinjësi të mirë, për stabilitet dhe për bashkëpunim rajonal". I pyetur në lidhje me gjendjen aktuale të bllokimit dhe mosfunksionimit të Gjykatës Kushtetuese, ka nënvizuar rëndësinë që ka përfundimi nga institucionet e rivlerësimit kalimtar, pra të institucioneve të vetingut të të gjitha procedurave për të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese që janë shqyrtuar në shkallën e parë, por që ende nuk janë marrë në shqyrtim përfundimtar. Përfundimi i këtij procesi është i domosdoshëm që të kemi sa më shpejt një Gjykatë Kushtetuese funksionale dhe të përgjegjshme, për t'i dalë për zot Kushtetutës së vendit dhe të gjithë debateve lidhur me kushtetutshmërinë e ligjeve, apo të akteve të ndryshme. Presidenti i Republikës ka vënë theksin në mesazhin e tij për plotësimin sa më shpejt të vakancave përfundimtare të krijuara në trupën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, për të cilën janë hapur procedurat e konkurrimit që prej muajit shkurt të këtij viti nga Institucioni i Presidentit të Republikës dhe më pas edhe nga Kuvendi.

Presidenti i Republikës ka përcjellë edhe një herë mesazhin dhe kërkesën që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të funksionojë sa më shpejt, për të vlerësuar kandidataturat, të cilat janë paraqitur në përputhje me procedurat kushtetuese e ligjore, si nga Presidenti i Republikës, ashtu edhe nga Kuvendi i Shqipërisë. Sa i përket çeljes së negociatave, Meta tha: "Unë mendoj se në cilindo rast çelja e negociatave e ndihmon Shqipërinë që të adresojë edhe më mirë, edhe më me efikasitet luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimin të organizuar, si dhe reformën në administratën publike". Sipas tij, "çelja e negociatave, ashtu sikurse edhe vetë opozita pavarësisht nga dallimet apo kritikën që ka ndaj qeverisë, e ka thënë besoj në mënyrë të qartë edhe konstruktive që çelja do ta ndihmojë Shqipërinë për t'i adresuar këto fenomene më mirë".

Presidenti i Republikës ka përcjellë edhe një herë mesazhin dhe kërkesën që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të funksionojë sa më shpejt, për të vlerësuar kandidataturat, të cilat janë paraqitur në përputhje me procedurat kushtetuese e ligjore, si nga Presidenti i Republikës, ashtu edhe nga Kuvendi i Shqipërisë. Sa i përket çeljes së negociatave, Meta tha: "Unë mendoj se në cilindo rast çelja e negociatave e ndihmon Shqipërinë që të adresojë edhe më mirë, edhe më me efikasitet luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimin të organizuar, si dhe reformën në administratën publike". Sipas tij, "çelja e negociatave, ashtu sikurse edhe vetë opozita pavarësisht nga dallimet apo kritikën që ka ndaj qeverisë, e ka thënë besoj në mënyrë të qartë edhe konstruktive që çelja do ta ndihmojë Shqipërinë për t'i adresuar këto fenomene më mirë".

KAMP PËR LUFTËTARËT E ISIS
Unë mendoj se çdo vendim duhet të merret në dialog të qeverisë me parlamentin me të gjitha institucionet e tjera, pasi çdo marrje përsipër e përgjegjësi të tilla duhet të gëzojë edhe një konsensus", -tha dje, Meta i pyetur nga gazetaret se çfarë mendon për idenë e ngritjes së një kampi për ish-luftëtarët e ISIS në Shqipëri.

SHISH dhe Shërbimi i Jashtëm, bashkëpunim për sigurinë

Helidon Bendo: Rritëm besueshmërinë në NATO e BE, por sfidat mbeten të mëdha

Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Shërbimi i Jashtëm shprehën angazhimin në forcimin e sigurisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë. Përfaqësues të Shërbimit Informativ të Shtetit morën pjesë në takimin informues me diplomatët e rinj të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Ndërsa të tjera, diplomatët u njohën edhe me mesazhin e zëvendës-drejtorit të SHISH-it, Helidon Bendo, i cili vlerësoi punën e dy institucioneve, si partner të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave kombëtare. "Uroj që bashkëpunimi ynë i deritanishëm të marrë vlerë të shuar edhe me kontributin tuaj. Vit pas viti, Shqipëria e ka rritur besueshmërinë e saj pranë partnerëve strategjikë, si një aktor i konfirmuar përkundrejt sigurisë së NATO-s dhe Bashkimit Europian", - tha Bendo. Në këtë kuadër, ai theksoi se "orientimi i Shqipërisë është shumë i qartë, përkaht aleatëve strategjikë, me të cilët ndajmë vlerë të përbashkëta". Megjithatë, sfidat tona mbeten të mëdha, ndërsa koncepti i sigurisë kombëtare tashmë ndryshon e shtrihet edhe përtej përcaktimit klasik. Në këtë drejtim, bashkëpunimi mes Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Shërbimit të Jashtëm merr një rëndësi të veçantë", - tha ai, ndërsa siguroi diplomatët për bashkëpunimin dhe ndihmën e pakursyer të komunitetit të inteligjencës.



Shitje me Ankand te Dyte nga Studio Permbarrimore L.D.C
"Tirall" me sip. 1,874m2 nga e cila 250 m2 eshte ndertes, me Nr. Pasurije 134/33/vol. 25, faqe 82, ZK 2436 e ndodhur ne Levan, Fier. Regjistruar ne Z. R. P. P. Fier ne emer te Shoq. Albjon shpk. Cmimi fillistarr per shirje eshte 6,180,854 Leka.
Data e shpalljes 15.05.2018
Data e zhvillimit 20.06.2018 deri ne oren 16.00
Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Rama shkarkon 6 drejtorë të ALUIZNI-t e Hipotekave: Motivi, performancë e dobët

Kryeministri Edi Rama ka shkarkuar katër drejtorë rajonalë të këtyre dy institucioneve është analizuar puna e drejtorëve rajonale. Mësohet se kreu i qeverisë ka evidentuar performancën e dobët të drejtorëve, ndryshe nga sa kishte kërkuar ai në takimet e mëparshme me krerët e Hipotekës dhe ALUIZNI-t, për t'i shërbyer me korrektesë qytetarëve dhe zbatuar ligjin. Rama e ka konsideruar të tepërt qëndrimin e tyre në detyrë. Sipas Ramës në këto 6 zyra ka pasur mosrealizim plani dhe performancë të dobët. Mes të shkarkuarve janë edhe krerët e Hipotekave të Sarandës, Pogradecit dhe Malësisë së Madhe. Një ditë më parë kryeministri Edi Rama shkarkoi kreun e Hipotekës së Krujës, Edmond Daci, vetëm tre muaj pasi ishte emëruar në këtë detyrë. Ndërkohë më herët, Rama pati një takim me koordinatorët e Platformës së Bashkëqeverisjes. Ai u shpreh në këtë takim se ka pasur një rritje të pjesëmarrjes në Platformën "Për Shqipërinë që duam", duke arritur në 10500 raste të evidentuara nga vetë qytetarët, nga të cilat janë 9349 të përfunduara. "Nga këto 8264 qytetarë kanë marrë zgjidhje, pasi më parë janë vonuar, janë penguar, janë torturuar në labirintin e burokracisë", -tha Rama. "Nuk ka asnjë rëndësi nëse jeton në qytet, apo jeton në fshat, nëse je i pasur apo i varfër, nëse ke një mbiemër të njohur, apo një mbiemër krejt të panjohur, nëse je i mosuar apo i ri, nëse je burrë apo je grua, mjafton që si qytetar i Republikës së Shqipërisë të shpenzosh maksimumi 3 minuta, për të pasur për 3 minuta në krah ministrin apo ministrën në fushën ku ka lindur shqetësimi yt dhe për të zgjidhur së bashku një problem që të është bërë i pazgjidhshëm në kundërshtim me ligjin dhe në cenim të së drejtës tënde", u tha Rama të pranishmëve. "Ne na duhet që brenda këtij mandati, administratën ta kemi transformuar në një shërbëtor të qytetarëve dhe në këtë mund ta realizojmë nëse qytetarët duan t'i kenë shërbëtorë punonjësit e zyrave dhe të mos i pranojnë, sikur i kanë skllavopronarë të të drejtave të tyre", -u shpreh Rama.

përputhje me Kushtetutën dhe në përputhje dhe me përgjegjësitë që i takojnë këtij institucioni ashtu sikurse edhe të gjithë institucionet e tjera kanë përgjegjësi të tyre të cilat do t'i ushtrojnë në kohën e duhur. Presidenti Meta, ka theksuar dhe një herë se "është e rëndësishme që në këtë çështje të ecim në

AKSIONI OPOZITAR INTERVISTA

Zyrtari demokrat: Rruga drejt pushtetit, referendum për çdo problem të qytetarëve

Zgjedhje të parakohshme? Maltezi: PD të jetë e besueshme

"Ndasitë, jo inate me njëri-tjetrin, por reflektim"

Valentina Madani

Jamarbër Maltezi, kreu i Departamentit për Turizmin në PD, tregon rrugët që e çojnë opozitën drejt pushtetit, por prej saj kërkon që të jetë e besueshme para shqiptarëve. Maltezi thotë për "Gazeta Shqiptare" se PD-ja para se të kërkojë zgjedhje të parakohshme, duhet të bëhet alternativë më e besueshme dhe të përballet me forcë dhe dinjitet përballë një qeverie të lidhur me krimin. Sipas tij, PD-ja më mirë në opozitë sesa e përlyer me korrupsionin. Zyrtari i lartë demokrat nuk përjashton mundësinë e një koalicioni PD-LSI për zgjedhjet e ardhshme lokale. Jamarbër Maltezi i kujton PD-së se duhet të bashkojë të gjithë opozitën kundër qeverisë "Rama", të cilën e quan një shkretëtirë.

Z.Maltezi si e konsideron aksionin e ndërmarë nga opozita kundër kimit dhe lidhjeve me politikën? Kjo betejë e bëri më të fortë opozitën apo dëshoi të përballë mosdorëheqjes së Fatmir Xhafajt si ministër i Brendshëm?

Kjo është një betejë e duhur, që i bën nder opozitës dhe i bën nder vendit. Mund të fitosh ose humbësh betejë në politike, por e rëndësishme është të jesh në anën e së vërtetës, që kur të shohësh veten më pas, të ndihesh mirë se ka mbrojtur një standard dhe ke ruajtur një raport të ndershëm me të vërtetën. Sa më gjatë e shtyn agoninë z.Rama, aq më rëndë do të jetë për të pasi opozita po i bën nder vendit. Çfarë nuk pranohet për policinë e thjeshtë, nuk mund të pranohet për ministrin, përndryshe do ishim në një dyfytërsi, një standard të dyfishtë.

Në gjykimin tuaj opozita duhet të kërkojë zgjedhje të parakohshme, apo të përgatitet për të fituar zgjedhjet e ardhshme lokale?

Opozita duhet të punojë për të fituar zemrat dhe



Jamarbër Maltezi, kreu i Departamentit për Turizmin në PD

mendjet e njerëzve. Duhet të punojë me njerëzit dhe për njerëzit. Duhet të demonstrojë që është në sinkron me nevojat dhe dëshirat e shqiptarëve, duhet të theksojë çështjet me rëndësi për vendin dhe të rrisë besueshmërinë që këtë zezona nuk do përsëriten më dhe që keqbërësit do i dërgojtë të përballen me një drejtësi të pakapur nga asnjë palë. Duke kryer këto detyra, opozita ngrihet në nivelin e kërkesave të kohës, bëhet alternativë më e besueshme dhe të përballet me forcë dhe dinjitet me të keqen në cilindo skenar.

...Dhe si mund të bëhet e besueshme?

Duke punuar me njerëzit dhe për njerëzit, duke shënuar hallet e tyre dhe duke i rikujtuar gënjeshttrat dhe mashtrimet e përditshme të qeverisë, duke bashkuar çdo kontribut opozitar, duke u mbajtur fort me të vërtetat e dhimbshme dhe duke ofruar më shumë shpresë se aeroporti. Këtu qeveria ka vuar shpresën dhe 500,000 shqiptarë (1/6 e popullsisë) ia kanë mbathur duke kërkuar azil a thua se Shqipëria është në luftë civile, apo është ndonjë shkretëtirë, ku toka nuk prodhon asgjë. Duhet të bashkohemi dhe të shohim përtej inateve të momentit për hir të së ardhmes së vendit.

PD dhe LSI duhet të shkojnë në zgjedhje si koalicion i përbashkët?

Nuk ka tagër askush veç forumeve të gjera të këtyre partive që të vendosin për koalicionet, prandaj ajo që mund të them është se PD-ja duhet të bëhet shtrati kryesor i besueshmë i çdokujt që është në opozitë me këtë barbari në pushtet. Natyrisht, PD-ja ka për detyrë të thërrasë dhe të bashkojë çdo forcë politike apo individ që dëshiron të përballet me të keqen që ka pushtuar vendin dhe të mos rrihet indiferente.

Çfarë po bëhet me procesin e riorganizimit të PD-së?

Ecën ku më mirë dhe ku me ngadalë, por nuk jam pjesë aktive e këtij procesi, siç isha pjesë e analizës së zgjedhjeve të 2017-ës.

Me statutin e ri të PD-së krerët e departamenteve nuk do të jenë më anëtarë të kryesisë së partisë. A do të rikandidoni për anëtar i këtij forumi?

Besoj që po. Për më tepër nuk përjashtohen apriori krerët e departamenteve, thjesht është vënë një vlerësim që 15 personat që marrin më shumë vota të jenë anëtarë të kryesisë, përveç kryetarit, nënkryetarëve dhe sekretarëve funksionalë, ndaj nuk përjashtohet mundësia që mjaft drejtues departamentesh do jenë në kryesinë më të vogël. E rëndësishme është që: 1, procesi të jetë sa më i ndershëm dhe mos ketë reklamime për numërimin e vo-

REFERENDUMET

"PD-ja duhet të përgatisë formularë me 1 pyetje "A jeni dakort që të shembet Teatri Kombëtar i arkitekturës Italiane për të ndërtuar kulla 20 katëshe miku i qeverisë?" Brenda javës struktura e PD-së mund të mbledhë 100,000 firma nëse do shkojë shtëpi më shtëpi. Ngjashëm me një hall tjetër qytetar. Duhet t'u shfaqemi shqiptarëve si forcë e besueshme për hallet e tyre", tha z.Maltezi.

tove të fituara dhe 2, kryesia dhe forumet të mblidhen sa më shpesh, sepse ndihmë në reflektimin e situatës.


Pas mbledhjes së Kuvendit Kombëtar dhe miratimit të statutit të ri, PD-ja është më e bashkuar edhe veçse thelloi më tej ndasitë?

Në përgjithësi mbledhja e forumeve është një lajm i mirë, pasi të ndihmon të reflektosh dhe ripërtërresh. Por, duhet reflektim dhe dëshirë për bashkim dhe fitore nga çdo anëtar i PD-së.

KOALICIONI

"Natyrisht PD-ja ka për detyrë të thërrasë dhe të bashkojë çdo forcë politike apo individ që dëshiron të përballet me të keqen, që ka pushtuar vendin dhe të mos rrijë indiferente", theksoi z.Maltezi.

Nuk di të them se sa është më e bashkuar PD-ja pas Kuvendit Kombëtar, por nëse ka vullnet, patjetër që ka zgjidhje. Duhet të reflektojmë dhe të përpigëmi të bashkohemi në një emërues të përbashkët nëse kemi në plan të ndërtojmë të ardhmen e fëmijëve në Shqipëri. Sado inat të kesh njërin apo tjetrin në PD, qartazi përballë kemi krimin e organizuar. Sado që personalisht mendoj që është më mirë që PD të jetë në opozitë se sa të



Mbledhja e fundit e Kryesisë së PD-së

përlyhet në korrupsion, qartazi nuk ka pasur asnjë zyrëtar të PD-së ndonjëherë që të ketë përlarë me bedelët e vet 120 milionë euro për 'check-up', 100 milionë euro për sterilizime, 178 milionë euro për 3 incineratorë, 90 milionë euro për dializë etj. Përballja me të keqen duhet të çojë të gjithë kontribuuesit në PD që të reflektojnë, të pranojnë kritikën, të falin diçka nga vetja për të parë përpara për hir të së ardhmes së fëmijëve tanë në këtë vend të bekuar nga Zoti, por të vjedhur dhe nëpërkëmbur nga banditët me pushtet.

Cilat janë rrugët që e çojnë Partinë Demokratike drejt pushtetit?

Të merret intensivisht me qytetarët dhe të dëshmojë vullnet për t'u marrë me hallet, jo veç me denoncimin e vjedhjeve galopante të qeverisë. Psh., PD duhet të prijë lëvizjet qytetare për referendume për çështje të rëndësishme. Për shembull, sot mendoj se PD-ja duhet të përgatisë formularë me 1 pyetje

kanalizojë të gjithë revoltën ndaj vjedhjeve të qeverisë në shpresë për shoqërinë e mpirë shqiptare. Dhe çdo muaj duhet të çojë zërin e saj në çdo shtëpi, përfshi edhe përmes fletushkave tematike apo me skandalet më të mëdha qeveritare. Duhet të tregojmë vjedhjet e Ramës, por edhe të shprehemi pa ekuivok se nuk do ketë asnjë gjyqtar apo ambasador të paguar nga Soros që mund ta shpëtojë Edi Ramën nga këto vjedhje.

Kush po e pengon integrimin e Shqipërisë në BE dhe a besoni se më 28 qershor, vendet e Unionit do të hapin negociatat me vendin tonë?

Qartazi që integrimin e pengon z. Rama me arrogancën e tij për të uzurpuar të gjitha pushtetet, me shpartallimin e Gjykatës Kushtetuese, ngërçin e gjykatave të tjera dhe me injorimin e hapur që u bën thirrje gjithnjë e më të forta dhe aspak diplomatike për drejtësinë e pavarur, që i tregon vendin Tahirit dhe shkarkimin e vëllait të kreut të trafikut të drogës në Bolonjë. Këta që bëjnë thirrje hapazi për reflektim janë në fakt mbështetësit me të singërtë të integritit të Shqipërisë, ligjvënës dhe shtetarë gjermanë, francezë dhe holandezë. E bëjnë këtë thirrje nga dëshira e mirë për të integruar Shqipërinë dhe jo për trille apo kapriço. Nuk mund të imagjinohet në asnjë vend që qeveria të kapë prokurorin e përgjithshëm, të zhduke Gjykatën Kushtetuese e për pasojë nuk mund të ankimohej asnjë ligj apo marrëveshje antikushtetuese, që ligjvënësit të ndalojnë prokurorin të ndjekë çështje penale ndaj një deputeti apo ish-ministri, etj. Përdërisa këto nuk janë standarde në përputhje me shtetin ligjor; këto nuk mund të jenë standarde për një vend që aspiron të hapë negociatat me BE.



Zbardhet propozimi që kryebashkiaku i Hasit i ka bërë këshillit bashkiak për Gafurr Mazrekun

Skandali, PD: Rama shpall "Qytetar Nderi" atentatorin e Azem Hajdarit


Noka: Kryeministri të tërheqë vendimin sa nuk është vonë

Valentina Madani

Partia Demokratike de noncoi dje se krye bashkiaku i Hasit ka propozuar dhënien e titullit "Qytetar Nderi" për atentatorin e liderit të demokracisë, Azem Hajdari. 21 vite pasi qëlloi me armë në parlament deputetin Azem Hajdari, në 18 shtator të 1997, socialisti Gafurr Mazreku propozohet të shpallet "Qytetar Nderi" nga ana e Këshillit Bashkiak të Hasit, me motivacionin "Personalitet, intelektual për kontributin e pashqir në pushtetin vendor". Dokumenti u publikua dje nga Partia Demokratike, e cila përmes deputetit Flamur Noka akuzoi kryeministrin Rama se qëndron pas këtij vendimi, që e cilësoi skandaloz. Noka i bëri thirrje Ramës ta tërheqë menjëherë këtë vendim. Deputeti i Kukësit bëri thirrje që të ndalej kjo gjë, pasi sipas tij, Azem Hajdari po vritet për herë të dytë. "Dy dekada pas atentatit brenda në parlament kundër Azem Hajdarit, atentatori, deputeti i Partisë Socialiste në atë kohë, Gafurr Mazreku propozohet nga Edi Rama për t'i dhënë titullin 'Qytetar Nderi' i Hasit. Partia Demokratike disponon propozimin që kryetari i Bashkisë së Hasit i ka bërë këshillit bashkiak për të nderuar një vrasës si Gafurr Mazreku me titullin më të lartë që mund të japë pushteti lokal", theksoi z.Noka. Nderimi i një deputeti që ka përdorur armën brenda sallës së parlamentit kundër Azem Hajdarit për demokratët është modeli që kryeministri ka ndjekur që pas ardhjes në pushtet. "Është modeli që nderon dhe u jep pushtet kriminelëve në parlament, qeveri dhe bashki, siç është rasti i Elvis Roshit, Mark Frrokut, Arben Ndokës dhe të tjerëve si ata. Është modeli që mburon krimin të lidhur me



Deputeti Flamur Noka



Faksimile e propozimit të kryebashkiakut të Hasit

DOKUMENTI

PD disponon vendimin ku ish-deputeti i PS-së, Gafurr Mazreku propozohet të nderohet me titullin më të lartë që jep pushteti vendor. "Dy dekada pas atentatit brenda në parlament kundër Azem Hajdarit, atentatori deputet i Partisë Socialiste në atë kohë, Gafurr Mazreku propozohet nga Edi Rama për t'i dhënë titullin 'Qytetar Nderi' i Hasit", theksoi z.Noka.

SHKURTE

Hapja e negociatave, Berisha e Mediu në Bundestagun gjerman

Ish-kryeministri Sali Berisha dhe kreu i Partisë Republikane, Fatmir Mediu ndodhen për një vizitë në Gjermani. Ata janë të ftuar në Takimin vjetor të Berlinit, ndërsa mësohet se kanë zhvilluar takime të shumta me deputetë gjermanë dhe politikanë vendës. Siç bëhet e ditur, ish-kryeministri Berisha dhe Mediu kanë zhvilluar disa mëngjesë e dreka pune. Diskutimet kanë qenë për situatën në Shqipëri dhe mundësinë e hapjes së negociatave nga ana e BE-së. Gjatë vizitës së tyre, ish-kryeministri Sali Berisha dhe kreu i PR-së, Fatmir Mediu kanë takuar deputetë gjermanë, Johannes Selle, Andreas Lamel, Volkmar Klein, Michael Link dhe Albert Eëiler.

Ndarja nga jeta e Perikli Dhales, Basha: lu dorëzua vetëm Zotit

Kreu i PD-së, Lulzim Basha shprehu dje ngushëllimet më të thella dhe ndau me të gjithë ndjekësit e tij në rrjetet sociale, dhimbjen e madhe për ndarjen nga jeta të Perikli Dhales, legjendës së bardhebluve dhe kryetarit për vite të degës së PD në lagjen 8. "Në këto momente të vështira ne jemi të gjithë pranë Donikës, Frenklit dhe Hertit, duke u përkulur me respekt dhe nderim para bashkëqytetarit tonë, krenarisë së futbollit bardheblu, kryetarit për vite të degës së PD për lagjen tonë, luftëtarit të pamposhtur gjatë gjithë jetës së tij, që sot lu dorëzua vetëm Zotit. U prehtë në paqen e tij!", shprehet z.Basha.

Denoncimi te Berisha: Administratorët ndihmonin miqtë

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital, që tregon se jo vetëm në kryeqytet, por edhe në rrethe të tjera të vendit ka pasur parregullsi në provimin e maturës. Sipas denoncuesit, në Lushnjë, në një shkollë, një e katërta e maturantëve kishin aparat celular me vete, ndërsa administratorët bënin foto të testeve dhe ua dërgonin mësueseve të matematikës dhe më pas ndihmonin kë kishin njohje apo u kishin marrë rryshfet.

"Air Albania", PD akuzo Rama: Ia dhe mikut Sinan Idrizi, gara e paracaktuar

Partia Demokratike akuzoi kryeministrin Edi Rama se në një akt klientelaz dhe korruptiv i ka dhënë mikut të tij, Sinan Idrizi, pronësinë e kompanisë shqiptare "Air Albania" me një investim prej vetëm 100 mijë lekësh. Deputetja Jorida Tabaku deklaroi se, "kompania është krijuar vetëm 9 ditë para daljes së vendimit të posaçëm të qeverisë, duke treguar qartë - tha ajo - se gjithçka ishte e paracaktuar pa garë, jo transparente dhe antilgjore". "Kompanisë me fond vetëm prej 100 mijë lekësh, Edi Rama i ka vënë në dispozicion kompaninë shtetërore 'Albecontroll', e cila do të financojë një kompani private klienteliste të lidhur me kryeministrin", deklaroi deputetja e PD-së. Kjo kompani nuk denoncohet për herë të parë nga Partia Demokratike. "Kjo është e njëjta kompani që Partia Demokratike e denoncoi në janar si pjesë të aferës korruptive me aeroportin e Vlorës dhe një kompani turke. Përpara marrëveshjes për aeroportin e ri, Edi Rama është shoqëruar në Turqi nga Sinan Idrizi", deklaroi zj.Tabaku. Deputetja e PD-së publikoi një foto, ku pretendohet se pronari i kompanisë "Air Albania" është në një takim të nivelit të lartë me presidentin Erdogdan dhe kryeministrin Rama, ndërsa ngriti pyetjet. "Të kujt janë paratë e 'Air Albania'? Për Illogari të kujt punon Sinan Idrizi? Paratë e kujt po pastron miku i Edi Ramës? A po investohen tek 'Air Albania' para të pista të familjes Rama dhe të ndonjë fondacioni të dyshimtë?"



teliste të lidhur me kryeministrin", deklaroi deputetja e PD-së. Kjo kompani nuk denoncohet për herë të parë nga Partia Demokratike. "Kjo është e njëjta kompani që Partia Demokratike e denoncoi në janar si pjesë të aferës korruptive me aeroportin e Vlorës dhe një kompani turke. Përpara marrëveshjes për aeroportin e ri, Edi Rama është shoqëruar në Turqi nga Sinan Idrizi", deklaroi zj.Tabaku. Deputetja e PD-së publikoi një foto, ku pretendohet se pronari i kompanisë "Air Albania" është në një takim të nivelit të lartë me presidentin Erdogdan dhe kryeministrin Rama, ndërsa ngriti pyetjet. "Të kujt janë paratë e 'Air Albania'? Për Illogari të kujt punon Sinan Idrizi? Paratë e kujt po pastron miku i Edi Ramës? A po investohen tek 'Air Albania' para të pista të familjes Rama dhe të ndonjë fondacioni të dyshimtë?"

qeverinë, siç është rasti i Saimir Tahirit dhe Agron e Fatmir Xhafaj", u shpreh deputeti i PD-së. Opozita shprehet se mbledhja e Këshillit Bashkiak të Hasit është ditën e hënë, ndaj i bëjnë thirrje kryeministrin Edi Rama që të tërhiqet nga vendimi sa nuk është vonë. PD-ja i kërkon kryeministrin të tërhiqet nga vendimi skandaloz sipas së cilit vret për herë të dytë liderin e lëvizjes së dhjetorit, Azem Hajdari. "Mbledhja e këshillit bashkiak është parashikuar për të hënë dhe

nga vendimi sa nuk është vonë. PD-ja i kërkon kryeministrin të tërhiqet nga vendimi skandaloz sipas së cilit vret për herë të dytë liderin e lëvizjes së dhjetorit, Azem Hajdari. "Mbledhja e këshillit bashkiak është parashikuar për të hënë dhe

ne i bëjmë thirrje Edi Ramës të tërheqë këtë vendim skandaloz sa nuk është vonë, sepse me këtë vendim po vret për herë të dytë liderin e dhjetorit, Azem Hajdari dhe po përdhos demokracinë në këtë vend", deklaroi deputetja e PD-së.

EPSPA SHOOERIA PERMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEVE ANKANDIT PER: 1 - Trulli me sip. 100 m², ZVRRP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 1/460, Vol.42, Fq.74, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri është e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sht.a. Çmimi me të cilin fillon ankandit është 5.715.520 LEKE. Ankandit do te zhvillohet ne date 28.06.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSPA" shpk te ndodhur ne Rr "Tsmali Qemali", Pall Fratrari, K.6, Tirane. 2 - Trulli + Ndertese, me sip. 552 dhe ndertesë 206.5 m², ZVRRP Tirane, Zona Kadastrale: 8150, Numri i Pasurisë: 6/43, Vol.20, Fq.17, e ndodhur ne Tirane. Kjo pasuri është e hipotekuar ne favor te TIRANA BANK sht.a. Çmimi me të cilin fillon ankandit është 952.000 EURO. Ankandit do te zhvillohet ne date 13.07.2018, ora 16.00 ne zyren e shoqerise "EPSPA" shpk te ndodhur ne Rr "Tsmali Qemali", Pall Fratrari, K.6, Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262111 ose ne www.epspa.al

Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shifite ne ankand pasurine : "Toke Are me sip 865 m² , me Nr pasurisë 131/86 Zona kadastrale nr 1896 , Volumi 9 , faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder " 2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasuritë e sipërpershkruar , është në vlerën 336,000 (Treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) Lekë Shitja e pasurisë do te behet (zhvillohet) me date 18.06.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhen perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr illogarie 41064051.

KPK: Dorëzoi dy kontrata noteriale me çmime fiktive

Vetingu, prokurori i Apelit, Gentian Trenova, nuk justifikon pasurinë

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën dëgjimore me prokurorin e Apelit Tiranë, Gentian Trenova, njëkohësisht kandidat për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Trenova ishte i pranishëm në seancë, ndërsa shoqërohej edhe nga avokati Saimir Lami. Trupa e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit e përbërë nga Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici u shprehën se nga verifikimi i ILDKPKI

dhe nga hetimi i thelluar i komisionit ka rezultuar se prokurori ka bërë deklaratim të rremë dhe ka mungesë të burimeve financiare. Sipas KPK prokurori i Apelit Tiranë, nuk justifikonte pasurinë për apartamentin si dhe vlerën prej 12 mijë euro të parapaguar në 2007. "Prokurori Trenova ka një apartament në rrugën 'Ferit Xhajko', 3 depozita bankare, kurse monetare nga rroga e bashkëshortes. Apartamentin ia dhurroi vëhrrit e vëhrrës. Prokurori ka dhurime cash

5 mijë euro nga prindërit e gruas, ka marrë hua nga motra dhe nëna. Ka dyshime të arsyeshme se Trenova ka gënjyer për apartamentin. Fillimisht ky apartament kishte vlerën 40 mijë euro në kontratën e dytë ky apartament është në vlerën e 1.9 milionë lekë. Deklarim të rremë për vlerën e 12 mijë eurove. Trenova ka bërë veprime fiktive pranë hipotekës. Në këtë banesë Trenova ka bërë shtesë kati. Trenova ka fshehur banesën, ka bërë deklaratim

të rremë për burimin financiar. Nuk justifikon paratë për shtesën e katit dhe pse ia ka dhuruar vëhrrit e vëhrrës e ka po ai në përdorim. Paratë e dhuruara nga të afërmit rezultojnë se ka mungesë dokumentacioni", njoftoi Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Sa u përket aftësive profesionale, në raport thuhet se prokurori Trenova nuk ka kryer hetime të thelluara për pasuritë e shtetasit V.L., i dënuar për trafik droge, ndërsa ka pushuar hetimet për prokurorin A.K., i dys-



huar për korrupsion. Gentian Trenova sqaroi se çështja e prokurorit ishte hetuar më herët nga dy kolegë të tij për më shumë se dy vjet dhe nuk kishin arritur në asnjë rezultat. Për rastin e shtetasit V.L., prokurori këmbëngu-

li se policia nuk i referoi asnjë provë. Në përfundim të seancës së tensionuar prokurori i Apelit, u shpreh se nuk ka pasur tendencë për të fshehur pasurinë dhe kërkoi të pranohen kundërshtimet e tij.

Në datë 21 qershor gjykata e Tiranës do të vendosë nëse do të rihapet çështja

Ina Allkanjari

Në gjykatën e Tiranës është zhvilluar ditën e djeshme seanca gjyqësore ndaj ish-truporës së Sali Berishës, Izet Haxhia. I dënuar me 25 vite burg për vrasjen e Azem Hajdarit, Haxhiaj doli para trupës gjyqësore duke mohuar të ketë gisht në këtë ngjarje. Pas kërkesës së Haxhiat për rihapjen e dosjes "Hajdari", gjykata e shtyu për në datë 21 qershor vendimin për këtë çështje, gjithashtu, trupa gjyqësore kërkoi nga prokuroria të sjellë dosjen hetimore. Kundër kërkesës së të dënuarit me 25 vite burgim, për vrasjen e deputetit Azem Hajdari, doli prokurori Petrit Bica. Ky i fundit i paraqiti gjykatës, disa shkresa, përmes të cilave shpreson të bindë trupën gjyqësore se Haxhia ka pasur dijeni për vendimin dhe nuk e ka ankimuar atë. Po ndryshe nga sa pretendoi prokurori, avokati Bashkim Nikolla, tha se klienti i tij nuk ka marrë asnjëherë dijeni për procesin, sikurse parashikohet nga ligji. Ai këmbënguli se është e drejtë e të mbrojturit prej tij, të dëgjohet përpara një gjykate. Nga ana tjetër Haxhia theksoi se nuk është njoftuar në atë kohë për dënimin e tij dhe i është rrezikuar jeta. Gjithashtu, ai akuzoi prokurorin Petrit Bica, si shërbëtor të Berishës. Më tej ai kërkoi që të pranohet kërkesa për ballafaqim me Sali Berishën në gjyq, duke paralajmëruar se nga 90' deri 98' jam dëshmitar i shumë ngjarjeve. "Prokurori që është në sallë është

Dosja "Hajdari", Izet Haxhia: Do flas, jam dëshmitar në ngjarje që i djejin Sali Berishës

Prokurori: Ishte në dijeni për vendimin e gjykatës dhe nuk e ankimoi atë

DËSHMIA

"Prokurori që është në sallë është shërbëtor i Berishës. Ekstradimi im si i interesonte qeverisë Berisha, u arrestova dhe ndaj meje u ndoqën të njëjta procedura gjyqësore si me Aldo Baren. Ai u ekstradua ndërsa unë jo deri sa ndryshoi sistemi", - tha Izet Haxhia.



Haxhia mohoj të ketë Hajdarit 12 shtatorin e vitit 1998, dhe se e vërteta sipas

tij do të dalë në dritë pas ballafaqimit me ish-kryeministrin Sali Berisha. "Ma ngarkuan një akuzë dhe unë nuk munda të mbrohem. Shkaku ishte se jeta ime ishte në rrezik. Por tani pas 27 vitesh, dua të flas për çështjen. Të përballem me Sali Berishën, sepse ai me denoncoi si vrasës të Azemit!", u shpreh Izet Haxhia. Më tej ai dhe avokati i tij mbrojtës kërkuan rigjykim dhe rihapjen e dosjes.

Surprizon Izet Haxhia, i propozon për martesë të dashurës

Izet Haxhia i befasoi të gjithë ditën e djeshme gjatë seancës gjyqësore, ku doli për të kërkuar sërish hapjen e dosjes së shkelurit. Ndërsa kërkoi të përballet me ish-kryeministrin Sali Berisha, Haxhia i bëri një propozim të hapur të dashurës së tij, Franca. Ata të dy u ndanë fizikisht kur Haxhia vendosi të kthehet në Shqipëri për t'u përballur me drejtësinë, por me sa duket dashuria që ndjen për Francën, është aq e madhe sa ka vendosur ta propozojë live, nga kafazi i hekurit teksa ndodhej në Gjykatën e Krimeve të Rënda. "Të dua pa fund, të dua përjetë! A pranon të martohesh me mua? Jam shumë i dashuruar me ty", shkruan Izeti me germa kapitale e me ngjyrë të kuqe në një letër. Kujtojmë se një muaj më parë nga burgu 302 ish-truproja e Berishës, i kishit premtuar të dashurës së tij shqiptare, se do të martoheshin me të kudo që të ndodheshin. Në mesazhin plot pasion të dashurisë u duk edhe portreti i vajzës bionde me emrin Franca.

shërbëtor i Berishës. Ekstradimi im si i interesonte qeverisë Berisha, u arrestova dhe ndaj meje u ndoqën të njëjta procedura gjyqësore si me Aldo Baren. Ai u ekstradua ndërsa unë jo deri sa ndryshoi sistemi, përse kjo. Kjo ka ndodhur sepse unë di shumë gjëra që Berishës i djejin shumë ngjarje, shumë krime që do flas nëse më jepni të drejtën. Nga 90' deri 98' jam dëshmitar i shumë ngjarjeve që i djejin Sali Berishës. Dua një ballafaqim me Sali Berishën, ndaj kërkesa ime është më rigjykoni", tha Izet Haxhia. Në seancën e kaluar ish-truproja i Sali Berishës argumentoi se nuk i është shmangur drejtësisë, por rrethanat nuk e lejuan të përballej me të, duke theksuar se shkak i largimit të tij drejt Turqisë ishte pasi ndihej i rrezikuar për jetën e tij.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi catering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit **10,200,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraqitsh pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi catering ne ambientet e Bankës së Shqipërisë për një periudhë 1 vjeçare"

Ofteta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Korrik 2018, ora 10:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Intervista/ Artur Sulçe: Kostoja dhe procedurat që duhet të ndiqen

Ina Allkanjari

Në rast se ndryshon pronësia e mjetit gjatë periudhës së sigurimit, të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kontrata e sigurimit nuk i kalojnë pronarit të ri. Pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit, ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm. Ky është ndryshimi i bërë së fundmi në nenin 25, në projektligjin e hartuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i cili ka mbërritur për shqyrtim në Kuvend. Sipas këtij ndryshimi, pronari i ri i mjetit motorik duhet të lidhë kontratën e sigurimit, ndërsa pronari i vjetër ka të drejtë të kërkojë kthimin e pjesës proporcionale të primit, në rast se nga kjo kontratë nuk është paguar ndonjë dëm. Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", eksperti rrugor Artur Sulçe ka shpjeguar ndryshimin që parashikon ky projektligji dhe se si ndikon ai tek qytetarët apo pronarët e automjeteve. Një tjetër ndryshim është edhe heqja e aktit të përdorimit, si dhe detyrimi për të ndryshuar pronësinë e automjeteve brenda 10 ditëve, që nga momenti që makina ka ndërruar pronar. Në intervistën e tij për "Gazetën Shqiptare", Artur Sulçe nënvizon se kjo bëhet me qëllim parandalimin e veprimtarive kriminale. Më tej i pyetur në lidhje me tarifimin e autostradës Tiranë-Durrës, eksperti thekson se është e nevojshme pagesa e një tarife të përbalueshme nga ana e qytetarëve, për ta risjellë në parametrat optimale. "Vendosja e një tarife do të detyronte kontraktorin ta mbante rrugën në një performancë të lartë në lidhje me sigurinë rrugore", shprehet eksperti Artur Sulçe.

Kohët e fundit ka pasur një sërë ndryshimesh për sa i përket shitblerjes së automjeteve. Një ndër të është edhe fakti se nëse ndryshohet pronësia e makinës siguracioni duhet bërë nga e para. Si e shikoni një ndryshim të tillë dhe çfarë impakti ka te qytetarët?
Në dijeninë time gjatë shitblerjes së një mjeti, i cili është i pajisur me sigurimin e detyrueshëm (TPL) kur ndryshon pronësia zakonisht ndryshon dhe policia e sigurimit, e cila vendoset në emrin e personit, i cili ka blerë mjetin, dhe vlera e këtij ndryshimi të policës së sigurimit është e rendit 600 lekë, ndërsa policia e sigurimit vullnetar natyrisht që do të ndryshohet pasi është për personin, i cili është poseduesi i mjetit. Zakonisht kjo vlerë e pagesës së ndryshimit të policës është e moderuar, por që normalisht për sa kohë sigurohet mjeti ligji nuk duhet ta vendosi si

"Sigurimi i automjeteve, si ndryshojnë rregullat për shitblerjen"

Eksperti i sigurisë rrugore shpjegon: Impakti që ka te qytetarët



Eksperti rrugor Artur Sulçe

kusht të domosdoshëm, pasi ky fenomen në personat juridik ku kanë njerëz të punësuar policia pritet vetëm për mjetin dhe jo për personin e autorizuar, i cili drejton mjetin.

Një tjetër ndryshim në legjislacion, konsiston në heqjen e aktit të përdorimit, pra në momentin që automjeti shitet, duhet që pronësia të ndryshojë brenda një afati 10 ditor. Cili është qëllimi dhe pasojat e këtij vendimi?

Heqja e aktit të përdorimit për mendimin tim duke iu referuar mënyrave të dhënies së një mjeti referuar Kodit Civil, ky ndryshim duhet të ishte referuar mënyrave, të cilat shpjegohen qartë në Kodin Civil, ndërsa ndryshimi i pronësisë të cilin e kanë vendosur brenda 10 ditësh kjo besoj se mund të lidhet dhe me shmangien e elementeve kriminale që mund të kryen, por edhe me dokumentacionin që duhet të ketë një përdorues mjeti në lidhje me kërkesat e Kodit Rrugor.

Prej pak ditësh ka nisur

Një rëndësi e veçantë në bërjen e rrugëve duhet t'i kushtohet dixhitalizimit të tyre në mënyrë që impakti i rrugëve të reja të jetë sa më të vogël në mjedis, në mënyrë që të gjenden mënyrat më efektive të transportit inteligjent duke rritur sigurinë rrugore

rikonstruksioni i autostradës Tiranë-Durrës. A mendoni se është periudha e duhur, në një kohë që ka nisur sezoni turistik?

Në lidhje me rikonstruk

sionin e rrugës interurbane kryesore Tiranë-Durrës, unë mendoj se riparimi i saj po bëhet në një kohë të papërshtatshme, pasi në vendin tonë ka filluar sezoni i

plazhit. Pra, kjo rrugë duhet të ishte në prioritet nga institucionet përkatëse për t'u riparuar që më parë pa ardhur sezoni turistik veror, pasi dihet qartë se në sezo-

SIGURACIONI

Gjatë shitblerjes së një mjeti, i cili është i pajisur me sigurimin e detyrueshëm (TPL) kur ndryshon pronësia zakonisht ndryshon dhe policia e sigurimit, e cila vendoset në emrin e personit, i cili ka blerë mjetin, dhe vlera e këtij ndryshimi të policës së sigurimit është e rendit 600 lekë, ndërsa policia e sigurimit vullnetar natyrisht që do të ndryshohet pasi është për personin, i cili është poseduesi i mjetit.

nin turistik veror rritet numri i mjeteve që lëvizin në këtë rrugë, duke ditur që numri i mjeteve që lëvizin në këtë segment trafiku është afër ngopjes, çfarë do të thotë se dhe në kushte normale kjo rrugë ka një trafik të rënduar.

Pas rikonstruksionit është përfolur për vendosjen e një tarife në këtë segment rrugor. A e mbështesni një vendim të tillë dhe sa duhet të jetë tarifa duke parë fluksin në këtë aks?

Vendosja e tarifave në këtë segment rrugor do të bënte që ky segment të rriste performancën e vet në lidhje me sigurinë rrugore, gjithashtu, do të detyronte kontraktorin ta mbante rrugën në një performancë të lartë në lidhje me sigurinë rrugore, duke eliminuar pikat e zeza të kësaj rrugë dhe duke bllokuar dhe hyrjet e daljet e pa miratuara nga ARSH. Po kështu kjo rrugë ka dhe rrugë alternative nga mund të lëvizin mjetet. Ndërsa në lidhje me çmimin ky duhet llogaritur me kujdes, pasi ka brenda probleme sociale, dhe çmimi duhet vendosur mbi bazën e një llogaritje mbi bazën e zhvillimit tonë ekonomik duke marrë parasysh pagën mesatare dhe minimale dhe koeficientët të tjerë, të cilët ndikojnë.

Dy nga projektet e qeverisë që pritet të nisin së shpejti janë ndërtimi i Rrugës së Arbrit dhe tuneli i Llogorasë. Ju si ekspert rrugor si i shihni këto dy projekte?

Në lidhje me këto projekte që parashtron qeveria jonë tani jemi mësuar disa bëhen për fushata, disa bëhen për demagogji, disa bëhen për zhvendosjen e mendjes së njerëzve nga problemet reale që ka ky vend, këtë përgjigje e ka dhënë saktë dhe Banka Botërore. Një rëndësi e veçantë në bërjen e rrugëve duhet t'i kushtohet dixhitalizimit të tyre në mënyrë që impakti i rrugëve të reja të jetë sa më të vogël në mjedis, në mënyrë që të gjenden mënyrat më efektive të transportit inteligjent duke rritur sigurinë rrugore, duke fituar në kohë dhe duke menaxhuar trafikun në shkallë maksimale, ashtu siç po veprom gjithë bota.

Në lidhje me çmimin ky duhet llogaritur me kujdes, pasi ka brenda probleme sociale, dhe çmimi duhet vendosur mbi bazën e një llogaritje mbi bazën e zhvillimit tonë ekonomik duke marrë parasysh pagën mesatare dhe minimale dhe koeficientët të tjerë, të cilët ndikojnë.



Implemented by **giz**

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

OPEN CALL FOR TENDER

- 1. GENERAL CONDITIONS**
- 1.1. Requester:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Country Office Albania in Tirana, Rr. Skenderbej, Nr 21/1.
- 1.2. Profile:** The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, is an experienced service provider and assists the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation. GIZ offers demand-driven, tailor-made and effective services for sustainable development
- 1.3. Subject:** The GIZ Office Tirana invites authorized and registered companies to express their interest in providing one off-road vehicle (4x4).
- 1.4. Companies should fulfill the following requirements:**
 - 1) Be an authorized and licensed dealer/partner from the manufacturer. According certificate must be provided.
 - 2) Provide a warranty up to 100.000 km drive for the vehicle.
 - 3) Offer quality service for the vehicle within the warranty duration. All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de
- 1.5. Due date for submitting the application and offer is 21.06.2018.** The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: **"PROVISION OF Off-Road Vehicle (4x4)"**, addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana,
Rr. Skenderbej, Nr 21/1
Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

EMIGRANTËT NË GREQI NDRYSHIMET NË LIGJ

Ndërmjetësi ndërkulturor: Llojet e lejeve të qëndrimit me tarifë 150 euro

Amendamenti i ri, rritje e gjobave për shqiptarët në Greqi

Malaj: Ku duhet të bëni kujdes që të mos penalizoheni

Voltiza Duro

Parlamenti grek ka miratuar amenda mentin e ri nga i cili do të përfitojnë reduktim të tarifave për disa lloj lelesh qëndrimi të gjithë emigrantët shqiptarë që jetojnë në shtetin helen. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Fatos Malaj, ndërmjetësi ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit dhe drejtues i organizatës së emigrantëve "Arogji - Përkrahja" tregon se ndryshimet do të hyjnë në fuqi në muajin shtator të këtij viti e më tej liston të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit për të cilat do të paguhet tarifa prej 150 eurosh. Malaj thekson se ky ndryshim do të bëhet për lejen e rezidentit afatgjatë (epi makron); lejen unike; kartën blu; lejen e qëndrimi për bashkim familjar; për studime; si dhe për kërkime. Ndërkohë ndërmjetësi ndërkulturor bën me dije se qeveria greke do të aplikojë një rritje të tarifave të gjobave për emigrantët që jetojnë e punojnë në këtë shtet.

Kur do të hyjë në fuqi amendamenti i ri i cili i miratua nga parlamenti grek?

Pas paraqitjes së kërkesave tonë për disa ndryshime që do të përmirësojnë jetën e emigrantëve shqiptarë në Greqi, parlamenti grek aprovi amendamentin e ri i cili do të hyjë në fuqi në muajin shtator të këtij viti.

Cilat janë disa prej pikave që do të pësojnë përmirësim nga shtatori i këtij viti?

Amendamenti për plotësim të dispozitave të Ligjit 4251/2014 (Kodi i Imigracionit dhe Integritimit Social) ka si synim të ripërcaktojë kushtet e përgjithshme për të drejtën e qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në Greqi. Amendamenti i propozuar nga Ministria e Politikës të Emigracionit rregullon dy çështje me in-



Fatos Malaj, ndërmjetësi ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit

PËRFITIMET DHE GJOBAT NGA LIGJI I RI

- Lejet ku do të aplikohet ulja e tarifave:**
 - Leja e qëndrimit afatgjatë (24,000)
 - Leje që japin të drejtën e punësimit - leje e përbashkët (51,400)
 - Leje e bashkimit familjar (134,000)
 - Leje për punëtorët me kualifikim të lartë
 - Leje për studime ose kërkime (900)
- Qeveria redukton koston e tarifave për të gjitha këto leje qëndrimi në 150 euro, sipas kostove të trajtimit të tyre.**
- Ministria po ndryshon, gjithashtu:**
 - A. Tarifat për rekrutimin e punëtorëve të përhershëm dhe sezonalë
 - Vendoset një tarifë e re për rekrutimin e emigrantëve për qëndrim të përhershëm.
 - Rritet tarifa për punëtorët sezonalë nga 50 në 100 euro.
 - B. Gjobat dhe të tjera
 - Parashikohet për herë të parë një tarifë prej 50 euro për një kërkesë për ri - trajtim
 - Rritet gjoba për dorëzimin e vounar të kërkesës nga 50 në 100 euro
 - Vendoset tarifë prej 100 euro për shtetasit e vendeve të treta që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye humanitare.
 - Shtohet gjoba në rastet e njoftimit të vounar për ndërrimin e adresës, e gjendjes personale (veçanërisht për ndryshim nënshetësie, lidhjen ose zgjidhjen e martesës, lindjen e fëmijës) humbjen e pasaportës ose ndryshimin, ose rinovimin e asaj, ose e çdo lloj dokumenti tjetër për udhëtim, për humbjen e lejes ose të kartës së rezidencës nga 50 euro në 100 dhe në rast përsëritje nga 100 në 200 euro.
 - Vendoset tarifë 100 euro për rilëshimin e lejes së qëndrimit.

teres të madh: shumën e tarifave dhe të gjobave të paguara nga emigrantët në procesin e dhënies ose rinovimit të lejeve të tyre; dhe synon të zgjidhë problem-in e mosmbulimit shëndetësor të fëmijëve në moshë madhore të emigrantëve të

ligjshëm në librezën shëndetësore familjare. **Sa do të jenë tarifat për lejet e qëndrimit??**

Sipas një vendimi të fundit të Gjykatës të Bashkimit Europian, kostoja e tarifave për lëshimin e lejeve të qëndrimit nuk respekton parimin e

RRITJA E TARIFAVE

"Për individët financiarisht të pavarur, tarifa do të rritet nga 300€ për grantin fillestar dhe 450€ për rinovimin në 1,000€ për të dyja rastet. Ndërkohë për pronarët e pasurive të patundshme tarifa do të rritet nga 500€ në 2.000€ për çdo person që merr leje qëndrimi për shkak të blerjes së pasurisë (të miturit nuk paguajnë)", thotë Malaj.

proporcionalitetit dhe është pengesë për ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga direktivat e komunitetit për emigrantët. Qeveria redukton koston e tarifave për të gjitha këto leje qëndrimi në 150 euro, sipas kostove të trajtimit të tyre. Respektivisht bëhet fjalë për: lejen e qëndrimit afatgjatë (24,000 mbajtës); lejet që japin të drejtën e punësimit, pra leje e përbashkët (51.400 mbajtës); lejen e bashkimit familjar (134,000 mbajtës); lejen për punëtorët me kualifikim të lartë; si dhe lejen për studime ose kërkime (900 mbajtës).

A ka lloje të tjera lelesh qëndrimi për të cilat nuk do të aplikohen zbritjet??

Në të drejtën kombëtare ekzistojnë edhe kategoritë e lejeve të qëndrimit të cilat nuk ofrojnë leje pune dhe nuk mbulohehen nga legjislacioni evropian. Për shembull, lejet për individët financiarisht të pavarur, leje qëndrimi për pronarët e pasurive të patundshme, për investitorët, etj. Këto tarifa do rriten shumë.

Sa do të shkojnë tarifat për lejet e sipërpërmendura?

Për individët financiarisht të pavarur, tarifa do të rritet nga 300 për grantin fillestar dhe 450 për rinovimin në 1,000 për të dyja rastet. Ndërkohë për pronarët e pasurive të patundshme tarifa do të rritet nga 500 në 2.000 për çdo person që merr leje qëndrimi për shkak të blerjes së pasurisë (të miturit nuk

ΕΦΗΜΕΡΙΔΑ ΤΗΣ ΚΥΒΕΡΝΗΣΕΩΣ
ΤΗΣ ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑΣ

12 Ιανουάριος 2018 Τεύχος Πρώτο Αρ. Φύλλου 181

ΝΟΜΟΣ ΥΠ' ΑΡΙΘΜ. 4546
Ενωσίση στην ελληνική νομοθεσία της Οδηγίας 2014/89/ΕΕ «πери θεμελιώσεως για το θελόσοο χυροσελινό σγδδσερο» και άλλες διατάξεις.

Ο ΠΡΟΕΔΡΟΣ ΤΗΣ ΕΛΛΗΝΙΚΗΣ ΔΗΜΟΚΡΑΤΙΑΣ
Εκδόμα τον ακόλουθο νόμο που φέρθηκε η Βουλή:

ΜΕΡΟΣ Α' ΕΝΣΕΜΑΤΙΣΜΗ ΤΗΣ ΟΔΗΓΙΑΣ 2014/89/ΕΕ

ΚΕΦΑΛΑΙΟ Γ' ΓΕΝΙΚΕΣ ΔΙΑΤΑΞΕΙΣ

Άρθρο 1
Αναφορά (Άρθρο 1 της Οδηγίας 2014/89/ΕΕ)

1. Σκοπός των άρθρων 1 έως και 15 είναι: α) η ενσωμάτωση στην ελληνική έννομη τάξη της Οδηγίας 2014/89/ΕΕ του Ευρωπαϊκού Κοινοβουλίου και του Συμβουλίου της 23ης Ιουλίου 2014, «πери θεμελιώσεως για το θελόσοο χυροσελινό σγδδσερο» (ΕΕ L 257/13.7.2014) και β) ο καθορισμός ενός πλαισίου για το θελόσοο χυροσελινό σγδδσερο, με σκοπό την προώθηση της βιωσιμής ανάπτυξης των θελόσοων ομοσπονδιών, των θελόσοων συλλόγων και των θελόσοων ομοσπονδιών, των θελόσοων συλλόγων και των θελόσοων ομοσπονδιών.

2. Ο νόμος αυτός δεν εφαρμόζεται σε δραστηριότητες με σκοπό αποκλειστικά την άσκηση ή την έννομη σφδρ-η.

3. Η εφαρμογή του παρόντος δεν θίγει τη μάρτυ και την αρμοδιότητα των θελόσοων ομοσπονδιών, σύμφωνα με τις σχετικές διατάξεις της Σύμβασης των Ηνωμένων Εθνών για το θελόσοο της Ολλανδίας.

Άρθρο 3
Ορισμοί (Άρθρο 3 της Οδηγίας 2014/89/ΕΕ)

Α. Για τους σκοπούς του παρόντος άρθρου οι εξής ορισμοί:

1. «θελόσοο» σημαίνει θελόσοο πολιτική ή πολιτική της Ευρωπαϊκής Ένωσης που έχει στόχο να προωθήσει την ανάπτυξη και συνεπή λήψη αποφάσεων με σκοπό τη μεταρρύθμιση της βιωσιμής ανάπτυξης, της οικονομικής ανάπτυξης και της κοινωνικής αλληλεγγύης των κρατών-μελών, όπως οι επόμενοι: αγορά ή παρτίδα, νηπιωτική και άλλες απεικονικές παρτίδες της Ευρωπαϊκής Ένωσης, καθώς και τους θελόσοους τομείς της, μέλη ομοσπονδιών και συνδέσμων με τη θελόσοο πολιτική και μέλη της θελόσοου ομοσπονδίας.

2. «θελόσοο χυροσελινό σγδδσερο» σημαίνει η διαδικασία με την οποία η αρμοδιότητα ανάλυσης και οργανώσεως της ενεργειακής δραστηριότητας στις θελόσοους και παρτίδες παρτίδες για να επιτευχθεί η σύνδεση ανάλογων, περιβαλλοντικών, οικονομικών, κοινωνικών και

Φακσίμλε e amandamentit të ri

QEVERIA GREKE
"Nga 2015 deri më sot, Tsipras nuk ka ulur koston në asnjë nga tarifat. Tani ai e bën atë në disa prej tyre pasi është i detyruar nga Komisioni Europian dhe nën kërcënimin e gjobave. Në të njëjtën kohë, megjithatë, imponon goditje të reja për migrantët për të kompensuar humbjet e të ardhurave", shprehet ndërmjetësi.

paguajnë). Praktikisht, në një familje prej pesë vetash, kostoja nga 2.500 eurosh rritet në 10.000 euro. Edhe për investitorët tarifa do të rritet nga 500 në 2.000 . Ka leje të tjera qëndrimi në ligin kombëtar, të cilat sigurojnë të drejtën për punë, por qeveria i përjashton ato nga ato lejet për të cilat ulet tarifa.

A do të ketë ulje tarifash për lejet e qëndrimit për brezin e dytë??

Për lejen e qëndrimit të brezit të dytë, tarifa mbetet 300 euro, pra dyfishi për një grup për të cilin ka një ndjeshmëri më të madhe. Për të mbuluar humbjet e të ardhurave, ministria po ndryshon, gjithashtu:

tarifat për rekrutimin e punëtorëve të përhershëm dhe sezonalë si dhe shtim të gjobave për emigrantët. Kështu do të vendoset një tarifë e re për rekrutimin e emigrantëve për qëndrim të përhershëm edhe pse deri më sot, nuk ka pasur asnjë tarifë pasi emigrantët që pranohen paguajnë atë që i korrespondon atyre. Si dhe do të rritet tarifa për punëtorët sezonalë nga 50 në 100 euro.

Sa do të jenë gjobat për emigrantët shqiptarë në Greqi??

Parashikohet për herë të parë një tarifë prej 50 euro për një kërkesë për ritrajtim si dhe do të rritet gjoba për dorëzimin e vounar të kërkesës nga 50 në 100 euro. Gjithashtu, do të vendoset tarifë prej 100 euro për shtetasit e vendeve të treta (që u referohen shërbimeve të emigracionit pas shërbimit e azilit) që aplikojnë për leje qëndrimi për arsye humanitare. Por do të shtohet gjoba në rastet e njoftimit të vounar për ndërrimin e adresës, e gjendjes personale (veçanërisht për ndryshim nënshetësie, lidhjen ose zgjidhjen e

martesës, lindjen e fëmijës) humbjen e pasaportës ose rinovimin e asaj ose e çdo lloj dokumenti tjetër për udhëtim, për humbjen e lejes ose të kartës së rezidencës nga 50 euro në 100 dhe në rast përsëritje nga 100 në 200 euro. Vlen të theksoj se do të vendoset tarifë 100 euro për rilëshimin e lejes së qëndrimit.

A ka ndonjë ndryshim në lidhje me sigurimin në librezën shëndetësore për fëmijët në moshë madhore?

Ministria e Punës së Një ndryshim në mars dhe në vend që të zgjidhte problem-in, ajo mbështeti praktikën e deritanishme duke përfshijtur fëmijët madhorë të emigrantëve nga sigurimi në librezën shëndetësore familjare. Për shkak të reagimeve tonë, qeveria i detyrua të premtonte që do korrigjojë gabimin duke vendosur përgjegjësinë në një tjetër dispozitë të Kodit të Emigracionit, pra këtë e tutje fëmijët do të mbulohehen nga librezat e prindit.

Si i vlerësoni ju vendimet e qeverisë greke lidhur me ndryshimet në ligin e emigracionit?

Natyrisht, zgjedhja e qeverisë është një goditje me arsyetimin e vetëm, nevojën për balancimin e të ardhurave të humbura nga vendimi i Gjykatës së Bashkimit Europian. Ndërsa Tsipras ishte në opozitë (dhe sidomos gjatë periudhës 2011-2012), ai krahasonte të ardhurat nga tarifat e emigrantëve me ato nga taksat e pronarëve të anijeve. Nga 2015 deri më sot, ai nuk ka ulur koston në asnjë nga tarifat. Tani ai e bën atë në disa prej tyre pasi është i detyruar nga Komisioni Europian dhe nën kërcënimin e gjobave. Në të njëjtën kohë, megjithatë, imponon goditje të reja për migrantët për të kompensuar humbjet e të ardhurave.

Vendimi i qeverisë/ Përfitues nga rritja me 2.8%, edhe ata që marrin pagesë pas 1 korrikut

Voltiza Duro

Pas datës 1 korrik të këtij viti, rreth 665 mijë pensionistë në vendin tonë do të përfitojnë rritje pensioni me 2.8% sipas vendimit të qeverisë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot vendimin e plotë të Këshillit të Ministrave sipas të cilit do të përfitojnë rritje të masës së pensionit disa lloj kategorish të pensionistëve. Kështu nga indeksimi do të preken edhe pensionet që do të caktohen nga data 1 korrik 2018-të. "Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit të jetë deri më 30.6.2018, përfshirë edhe këtë datë", theksohet në vendim. Në këtë të fundit, më tej nënvizohet se pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me ligjin, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, nuk do të jenë më pak se 13 378 lekë dhe më shumë se 26 757 lekë në muaj. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave edhe pensionet e parakohshme, me datë fillimi nga 1.7.2018 e në vazhdim,

Kompensimet mujore, ja kategoritë e pensionistëve që përfitojnë

Sa do të jetë masa për pensionin e pleqërisë e invaliditetit

MASAT MINIMALE DHE MAKSIMALE

Pas datës 1.7.2018, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të qytetit me datë fillimi deri në 31.12.2014, shtuar me kompensimet nuk mund të jenë më të vogla se 15 528 lekë në muaj, të ardhurat maksimale arrijnë 27 257 lekë në muaj, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të fshatit nuk mund të jenë më të vogla se 10 051 lekë në muaj ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e parakohshme, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 528 lekë në muaj.

nuk do të jenë më pak se 13 378 lekë në muaj. Kompensimet mujore



Foto ilustruese

Të gjithë përfituesit e pensioneve me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit, do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura

mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave. Por kjo me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit të pensioneve të jetë deri në 15 028 lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneve. Ndërsa për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, kjo shumë e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, pas indeksimit 2.8% nuk duhet të jetë më shumë se 14 528 lekë në muaj. Sipas vendimit është parashikuar që kompensimi do të prekë edhe pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", por me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave, të arrijë deri në 9 851 lekë në muaj.

"Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve"; nr.763, datë 27.12.2006, "Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve"; nr.415, datë 27.4.2009, "Për rritjen e pensioneve"; dhe nr.477, datë 30.6.2010, "Për rritjen e pensioneve", do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009, me datë fillimi nga 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë

KOMPENSIMET MUJORE

Përfituesit e pensioneve do të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë:

- a) deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, përfshirë edhe përfituesit e pensioneve sipas ligjit nr.150/2014;
- b) deri në 14 528 (katërmëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë në muaj, për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;
- c) deri në 9 851 (nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

■ Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave do t'i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensionet me datë fillimi nga 1.7.2018 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 15 028 (pesëmbëdhjetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj.

■ Përfituesit e pensioneve, do të marrin edhe kompensimet "Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse"; "Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajurit dhe gazit të lëngshëm".

jetë mijë e njëzet e tetë) lekë në muaj", thuhet në vendimin e qeverisë. Në këtë të fundit theksohet se pas datës 1.7.2018, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të qytetit me datë fillimi deri në 31.12.2014, shtuar me kompensimet nuk mund të jenë më të vogla se 15 528 lekë në muaj, të ardhurat

maksimale arrijnë 27 257 lekë në muaj, të ardhurat minimale nga pensionet e plota të fshatit nuk mund të jenë më të vogla se 10 051 lekë në muaj ndërsa të ardhurat minimale nga pensionet e parakohshme, shtuar me kompensimet, nuk mund të jenë më të vogla se 15 528 lekë në muaj.



Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1,100 Lekë	1,300 Lekë	1,300 Lekë	1,900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500		3000
SMS Kombëtare			500	400	400	300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitime të tjera					10 GB (Social & Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123."

Peshkopi/ Ekzekutori e kishte fshehur kallashin në murin e banesës para 7 vitesh

Enver Doçi

DIBËR

Një javë pas krimit të dyfishtë që tronditi Peshkopinë, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me 26-vjeçarin Qemal Sela, i cili pak orë pas kthimit nga Anglia, ekzekutoi me breshëri kallashnikovi nënën dhe babain. Bëhet fjalë për bashkëshortët Flamur dhe Zeqimete Sela, përkatësisht 55 dhe 50 vjeç, mbi të cilët i riu zbrazi një karikator me plumb. Burime të sigurta nga policia e Dibërës dhe bënë me dije për "Gazeta Shqiptare" se autori i ngjarjes së rëndë të ndodhur në lagjen "Lixha" të qytetit të Peshkopisë ka deklaruar në momentin e arrestimit se do të vriste edhe vëllain dhe dajën e tij. Mësohet se ndërhyrja në kohë e patrullës së policisë, e cila ishte afër hotelit 4-katësh ku u vranë burrë e grua, ka shmangur vrasjen e dy familjarëve të viktimave. Ndërkaq, burimet e mësipërme pohuan se Qemal Sela ka debatuar ashpër me të atin sapo ka mbërritur në aeroportin e Rinasit. Sipas bluve, emigranti ka refuzuar të udhëtojë me babain që kishte dalë ta priste në aeroport me një taksì të prenotuar që në Peshkopi. Kjo për faktin se ai akuzonte prindërit e tij se kishin prishur të gjitha paratë që ai kishte dërguar nga Anglia përgjatë 7 viteve emigracioni për të ndërtuar 2 hotele që shërbenin për personat që frekuentojnë llixhat e Peshkopisë. Më 11 qershor, Gjykata për Krimet e Rënda në Tiranë caktoi masën e sigurisë "Shttrim i detyrueshëm në spital psikiatrik" ndaj 26-vjeçarit Qemal Sela, pasi dyshohet se ai vuan nga probleme mendore. Aktualisht autori i vrasjes së prindërve të tij ndodhet në spitalin e burgut në kryeqytet.

KONFLIKTI BABË E BIR

Mbrëmjen e 6 qershorit, Qemal Sela ka mbërritur nga Londra në aeroportin e Rinasit. "Gazeta Shqiptare" ka mundur të sigurojë "përplasjen" mes babë e bir në aeroport, përplasje kjo që pak orë më vonë degjeneroi në vrasje. Sipas bluve, 55-vjeçari Flamur Sela kishte prenotuar një taksì që nga Peshkopia për të marrë të birin emigrant. Në momentin që 26-vjeçari ka zbritur nga

Vrasja e dyfishtë, Qemal Sela, policëve: Nëse nuk do më kapnit, do vrisja edhe vëllain e dajën

Zbulohet sherri mes babë e bir në Rinas, 26-vjeçari refuzoi të udhëtonte me taksinë që kishte prenotuar i ati



26-vjeçari Qemal Sela



Hoteli në lagjen "Lixha" në Peshkopi

ARMA E FSHEHUR NË MUR

Burime policore deklaruan për "Gazeta Shqiptare" se Qemal Sela e kishte fshehur në murin e shtëpisë kallashnikovin me të cilin vrau prindërit. Sipas bluve, 26-vjeçari para se të ikte për në Angli e kishte futur armën në mur, të cilin më pas e kishte shtuar. Më 7 qershor, ditën e ngjarjes, ai e ka prishur murin me sqepar dhe ka marrë armën, me të cilën ekzekutoi nënën dhe babain.

avioni, babai i ka dalë para dhe i ka thënë: "Eja bir se kam marrë taksì për të shkuar në shtëpi". Por djali nuk ka pranuar, ndërsa ka debatuar me të atin për paratë që kishte dërguar nga Anglia. "Nuk do vij me ty", i ka thënë Qemal Sela të atit. Ndërkaq, ai i është drejtuar një taksisti në Rinas dhe e ka pyetur: "Sa të bën rruga deri në Peshkopi"? Taksisti i ka thënë 120 mijë lekë të vjetra. "Unë të jap 150 mijë lekë, më çon në shtëpi". E ndërsa 26-vjeçari është nisur për në Peshkopi, Flamur Sela ka marrë djalin tjetër dhe i ka

RRËFIMI I VRASËSIT

Pas krimit të dyfishtë, Qemal Sela ka folur përçarjt gjatë marrjes në pyetje në polici. I pyetur nga blutë për krimin e dyfishtë në familje, ai ka thënë: "Vrava dy grabitës. Ata nuk janë prindërit e mi. Nënën time e njoh nga dhëmbët. Nuk është ajo që vrava. Ai tjetri e ka emrin Flamur, por nuk është babai im". Gjithashtu, 26-vjeçari është shprehur se nuk e ka emrin Qemal, pasi e kishte ndërruar në Angli. "Unë nuk jam Qemali, e kam emrin Zeqir".

akuzuar se i kishin prishur paratë që u kishte dërguar nga Anglia dhe se me to kishin ngritur hotele.

TRAGJEDIA

Paraditen e së enjtes së 7 qershorit, Qemal Sela bashkë me vëllain më të madh (28-vjeçar) ka dalë për të bërë xhiro në qytetin e Peshkopisë, por janë grindur sërish për paratë. Teksa ishin duke debatuar, ai i ka thënë vëllait se do të kthehej në banesë.

Sapo ka shkuar në shtëpi, një ndërtesë 4-katëshe që shërben si hotel për personat që frekuentojnë llixhat e këtij qyteti, ai ka marrë kallashnikovin me dy karikatorë me fishekë. 26-vjeçari ka qëlluar me breshëri të atin, Flamurin në katin e parë duke e lënë të vdekur në vend. Pastaj ka qëlluar për vdekje dhe nënën, Zeqimeten. Mësohet se ai ka zbrazur të gjithë karikatorin me plumba mbi

VENDIMI I GJYKATËS

Më 11 qershor, Gjykata për Krimet e Rënda në Tiranë caktoi masën e sigurisë "Shttrim i detyrueshëm në spital psikiatrik" ndaj 26-vjeçarit Qemal Sela, pasi dyshohet se ai vuan nga probleme mendore. Gjatë seancës gjyqësore, ai nuk ka qenë i vetëdijshëm për të dhënë deklaratën e tij, ndërsa herë pas here ka folur përçarjt. Aktualisht autori i vrasjes së prindërve të tij ndodhet në spitalin e burgut në kryeqytet.

prindërit (i ka mbetur vetëm një fishek pa shkrepur). Na atë moment, pranë hotelit në lagjen "Lixha" ishte një patrullë policie, e cila sapo ka dëgjuar krismat e armës, ka ndërhyrë. Ata kanë parë agresorin me armë në dorë dhe e kanë urdhëruar të ulë armën. I riu është bindur dhe nuk ka bërë rezistencë. Sapo ka hipur në makinën e policisë, ai u ka thënë policëve që po e shogëronin për në komisariat. "Ndizini dritat. Ndizini sirenat dhe bjerini borisë që njerëzit të hapin rrugën". Gjatë rruges për në komisariat, policët e kanë pyetur autorin i vrasjes së dyfishtë se ku po shkante me armë në dorë. Ndërkaq, ai u ka thënë se ai po shkante të vriste vëllain dhe dajën e tij. "Nëse nuk do më kapnit ju, unë do vrisja dhe këta dy të tjerët", është shprehur Qemal Sela.

Terrorizoi banorët duke qëlluar me armë në ajër, pranga shijakasi

DURRËS - Një 24-vjeçar ka përfunduar në pranga, pasi akuzohet se ka qëlluar me armë në ajër, duke terrorizuar banorët e Shijakut. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se bëhet fjalë për të riun me inicialet E.B. Gjatë kontrollit të ushtruar nga blutë, në banesën e tij u gjetën disa gëzhoja, marijuanë dhe kokainë. "Më datë 13.06.2018 ka ardhur një telefonatë se një person qëllon me armë zjarri në ajër. Nga veprimet paraprake të kryera nga ana e policisë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit E.B., banues në Shijak, pasi nga kontrolli i ushtruar në oborrin e banesës së tij u gjetën disa gëzhoja. Ndërsa, në banesë iu gjetën e bllokuan 804 gr. lëndë narkotike e llojit marijuanë, 1 dozë lëndë narkotike e llojit kokainë dhe një thikë", thuhet në njoftimin e policisë.

Kanosit ish-të dashurën për t'i marrë 2 mijë euro, arrestohet 28-vjeçari

LUSHNJE - Policia e Fierit ka arrestuar një 28-vjeçar në Divjakë, pasi është dënuar me 7 muaj e 3 ditë burg, për veprën penale "Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie dhe pasurisë". Në pranga ka përfunduar Kleanthi Todri, pasi u kallëzua në gusht të vitit të kaluar nga nëna e një vajze të mitur se e kërcëntonte duke i kërkuar 2 mijë euro. Mësohet se i riu kishte pasur një marrëdhënie të shkurtër me vajzën dhe pas ndarjes e kërcëntonte që t'i jepte shumën e parave.

NJOFTIM

SHPALLJA E VENDEVE TË PUNES PER ADMINISTRATOR

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë shpall konkursin për tre pozicione pune:

1. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë
2. Administrator në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike
3. Administrator në Fakultetin e Mjekësisë Dentare

Afati i pranimit të dokumentacionit deri në datë 26.06.2018.

Informacioni i detajuar për kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar gjendet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë www.umed.edu.al dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

KABINETI PASURITE

Senida Mesi me bashkëshortin disponojnë 14 llogari bankare, shtëpi e makina

Zbulohet pasuria e Edi Ramës, ja sa merr kryeministri nga pikturat

Pasuria modeste e ministrit të Brendshëm, jeton me pagën dhe shpërblimet

Zbarden pasuritë e kabinetit "Rama 2". Kryeministri Edi Rama ka deklaruar të ardhurat nga rroga, nga honoraret dhe fitimet nga shitja e pikturave. Zëvendëskryeminstri Senida Mesi dhe bashkëshorti i saj disponojnë 14 llogari bankare, dy apartamente dhe automjet. Bashkëshorti zëvendëskryeminstri zotëron 100% të aksioneve të një kompanie. Ministri i Brendshëm deklaroi si të ardhura vjetore pagën dhe të ardhurat nga komisionet e përhershme e të përkohshme në Kuvend. Fatmir Xhafaj ka deklaruar si pasuri të patundshme një dyqan në Vlorë nga dhënia me qira e të cilit ka marrë 13770 euro në një vit. "Gazeta Shqiptare" publikon pasuritë e kabinetit qeveritar, të cilat u referohen deklaratave të pasurisë, dorëzuar prej tyre në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, të cilat

janë zbardhur nga "Open Spending Albania".

NDRYSHIMI I PASURISË

Nuk është rroga e vetmja pasuri që mbahet kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Kjo, pasi numri një i qeverisë merr të ardhura edhe nga punët artistike, apo edhe honoraret ku ka deklaruar se merr 51.000 lekë. Kreu i qeverisë ka deklaruar se të ardhura neto nga paga merr 2.015.199 lekë, ndërsa të ardhura neto nga krijimtaria artistike, shitje e punëve artistike merr 3.894

352 lekë. Ndërkaq, sipas "spending data.al", nisur nga deklarimi i Ramës, deri tani ka shlyer shumën prej 4.852 euro për kredinë me vlerë 80.000 euro, afat 10-vjeçar të marrë në datë 22.10.2013 pranë një banke të nivelit të dytë. Kredia është pjesë e regjistrimit martesor dhe detyrimi i mbetur në datën 31 dhjetor 2017 është 26.460 euro. Ndërsa edhe bashkëshortja e tij, Linda ka shlyer shumën prej 4.853 euro për kredinë e përbashkët me vlerë 80.000 euro, me afat 10-vjeçar të marrë në

datë 22.10.2013. Nga ana tjetër, Linda Rama, gjatë vitit 2017 deklaroi të ardhura nga puna si eksperte 1.849.983 lekë, të ardhura nga honoraret 1.241.276 lekë, qira nga apartamentet 2.712.180 lekë dhe interesa bankare 2.394 lekë. Ndërkaq, i biri i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, Gregor Rama, rezultoi se jeton me qira si dhe se gjatë vitit 2017 ka marrë 400 mijë lekë të vjetër borxh. Nga shitja e veprave të artit, Gregori gjatë vitit 2017 ka fituar 28 mijë euro.



Edi RAMA

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave

Koha e marrjes së detyrës/mandatit 2013-09-10

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave

PS mandati II - Këshilli i Ministrave

Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.09.2013

Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet

1) Të ardhura neto nga paga, 2.015.199 Lek.

2) Të ardhura neto nga honorare, 51.000 Lek.

Të ardhura nga Bonuse Nuk ka

Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Nuk ka

Të ardhura Qiradhënie Nu k ka

Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka

Të ardhura nga Ortakëri/Aksione Nuk ka

Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Të ardhura neto nga krijimtaria artistike/shtetje e punëve artistike, 3.894.352 Lek.

Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

1) Bashkëshortja, të ardhura neto nga paga dhe puna si eksperte, 1.849.983 Lek.

2) Bashkëshortja, të ardhura neto nga interesat bankare, 2.394 Lek.

3) Bashkëshortja, të ardhura neto nga qiradhënia, 2.712.180 Lek.

4) Bashkëshortja, të ardhura neto nga honorare, 1.241.276 Lek.

5) I biri, të ardhura neto nga shitja e veprave të artit, 28.003 Euro

Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

1) Pakësim me 319.183 Lek i të ardhurave personale të subjektit në llogarinë bankare.

2) Bashkëshortja, shtesë me 5.092.665 Lek në llogarinë bankare të të ardhurave personale.

3) Bashkëshortja, pakësim me 50.000 Lek i gjendjes cash.

4) Bashkëshortja, shtesë e pasurisë nga blerja e tokës ullishte me arë me sipërfaqe 2.240 m² në Surrat dhe vlerë 6.930.000 Lek, blerë për arsye funksionale të terriorit ku është ndërtuar banimi.

5) Subjekti, shitje e apartamentit parafabrikat me sipërfaqe 59 m² i përfutur nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993 dhe rivlerësuar në vitin 2012 nga ZVRPP sipas gmirimit fiskal, vlera e raportuar e shitjes është 5.000.000 Lek.

6) I biri, pakësim me 9.100 Lek në llogarinë bankare pranë Tirana Bank.

7) I biri, shtesë me 3.131,31 Euro në llogarinë bankare në Tirana Bank.

8) I biri, shitjeje e detyrimit me vlerë 432.000 Lek, për kontratën e qirasë me afat dyvjeçar.

9) I biri, shitjeje e shumës prej 400.000 Lek për detyrimin huasë.

ALBtelecom, me plot 11 kanale të reja televizive në shtëpitë tuaja

ALBtelecom vjen me një bashkëpunim tjetër të rëndësishëm dedikuar posaçërisht klientëve të tij besnikë. Të gjithë përdoruesit ekzistues e të rinj të paketave SuperMiks në ALBtv, do të kenë mundësinë të përjetojnë një eksperiencë të re dhe ekskluzive.

Tashmë përdoruesve të shërbimit ALBtv do t'i ofrohet mundësia për të ndjekur pa pagesë edhe plot 11 kanale televizive të Radio Televizionit Shqiptar. Këto kanale do t'i bashkohen kanaleve të tjera pjesë e paketave SuperMiks të platformës ALBtv, për të bërë kështu akoma më të plotë dhe argëtuese eksperiencën për të gjithë të apasionuarit pas televizionit. Mundësia për të zgjedhur midis një game të gjerë të kanaleve me muzikë, lajme, sport apo filma, sjell më tepër larmi dhe ngjyra në çdo shtëpi.

Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Shqiptar, z. Thoma Gëllçi dhe Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom z. Tahsin Yilmaz shprehuan gjatë një takimi në ambientet e RTVSH-së, disa nga aspek-



tet e këtij bashkëpunimi strategjik.

Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom z. Tahsin Yilmaz në fjalën e tij nënvizoi se: "Ndihemi të lumtur që po pasurojmë paketat tona. Çdo risi e ofruar flet qartë se ne jemi në kërkim të përmirësimit të vazhdueshëm. Paketat e kompletuara të shërbimit televiziv

në mënyrë shumë praktike mund të përdoren paralelisht në pajisje si televizor, tablet dhe telefona të zgjuar".

Ai shtoi se: "E gjithë kjo vjen si rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme të kompanisë për të rritur standartin e ofrimit të shërbimeve dhe për të përmbushur pritshmëritë e të gjithë

klientëve, me dëshirën që përdoruesit e shërbimit ALBtv të jenë gjithmonë një hap përpara.

Ju mund të ndiqni emisionet apo filmat tuaj të preferuar dhe të informoheni mbi të rejat e fundit në vend dhe jashtë tij shumë thjesht dhe mbi të gjitha pa pagesë shtesë."

Një prej risive më të rëndësishme në platformën e ALBtv, së fundmi ka qenë edhe prezantimi i funksioneve të reja nDVR që konsistojnë në përdorimin e programeve sipas kërkesës, me komandat RECORD: Zgjidh dhe regjistron programet e tua të preferuara për t'i parë në një moment të dytë. CATCH UP: Kthehu në kohë dhe rishiko programet e transmetuara më parë, deri në 72 orë. PAUSE: Ndalo programin televiziv në transmetim për ta vazhduar atë në një moment të dytë dhe RESTART: Rifillo një program televiziv nga e para.

Shërbimet e reja do të shfaqen automatikisht në aparatet e klientëve, ndaj nuk do të jetë e nevojshme të kryhet ndonjë veprim praktik për t'i përfutur ato.



Lindita NIKOLLA

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 2013-09-11
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet

- 1) Të ardhura vjetore nga paga si Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 1 015 567 Lek.
- 2) Të ardhura nga pagesë kalimtare gjatë periudhës 23.05.2017-10.09.2017 pas largimit nga funksioni, 524 280 Lek.

Të ardhura nga Bonuse Të ardhura vjetore nga dietat, 22 550 Lek.

Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Nuk ka

Të ardhura Qiradhënie Nuk ka

Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka

Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka

Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka

Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, të ardhura vjetore neto me vlerë 1 308 000 (paga mujore prej 109 000 Lek) Lek nga pozicioni Dekan i Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Inxhinierisë Fizike dhe nga Universiteti Politeknik i Tiranës pranë Raiffeisen Bank.

- 2) Bashkëshorti, të ardhura me vlerë 215 825 Lek si anëtar i Universitetit Politeknik të Tiranës, nga udhëheqje doktoraturash, oponencë mbrojtje doktorature dhe orë suplementare gjatë periudhës 23.05.2017-31.12.2017.

- 3) Vajza, të ardhura vjetore neto me vlerë 1 023 768 Lek (paga mujore prej 85 314 Lek) nga paga si specialiste në Departamentin e Stabilitetit Financiar në Bankën e Shqipërisë, në llogarinë pranë BKT.

Të ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera Nuk ka



Niko PELESHI

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 11.09.2013
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet

- 1) Të ardhura neto nga paga si Zv.Kryeminister për periudhën Janar-Maj, 1 140 605 Lek.
- 2) Të ardhura neto nga paga si Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për periudhën Shtator-Dhjetor, 412 224 Lek.

Të ardhura nga Bonuse Nuk ka

Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Të ardhura nga pjesëmarrja në bordin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, 40 425 Lekë.

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Të ardhura nga interesat e përfutura nga depozitat e veta, të bashkeshortes dhe fëmijëve, 36 233 Lekë.

Të ardhura Qiradhënie Nuk ka

Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka

Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka

Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka

Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Të ardhura nga paga neto e bashkeshortes për periudhën Janar-Dhjetor 2017, si Senior Associate në Ernst & Young, 2 341 756 Lek.
- 2) Të ardhura nga interesa bankare në llogari të bashkeshortes: 24 315 Lek.

Të ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

- 1) Pakësim me 794 701 Lek i gjendjes së llogarië bankare në Raiffeisen Bank.
- 2) Shtesë me 208,03 Euro në llogarinë bankare në ISPA Bankë, për pagësën e kësteve të kredisë, llogari e përbashkët me bashkeshorten.
- 3) Pakësim me 515 890 Lek dhe mblyllje e llogarisë bankare në ISPA Bank.
- 4) Shtesa në llogaritë bankare të tre fëmijëve me vlera për katësisht 191,25 USD; 223,36 USD dhe 221,68 USD .
- 5) Bashkëshortja, pakësim me 18 092 Lek në llogarinë rrjedhëse pranë ISPA Bank.
- 6) Bashkëshortja, shtesë me 18 166 Lek në llogarinë pranë Alpha Bank, e krijuar nga paga.
- 7) Bashkëshortja, shtesë me 24 216 Lek nga interesat mbi depozitën me afat.
- 8) Bashkëshortja ka shlyer 6 727 Lek për detyrimin e kartës së kreditit me limit 200 000 Lekë pranë Alpha Bank, gjendja e të cilës në datë 31 Dhjetor 2017 është 687 lek



Mirela KUMBARO

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 11.09.2011
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Ministër i Kulturës
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur E pavarur

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet Të ardhura nga paga si Ministër i Kulturës, 1 661 759 Lek.

Të ardhura nga Bonuse Nuk ka

Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies

- 1) Të ardhura nga interesat e depozitës në La Banque Postale Paris, 113 Euro.
- 2) Të ardhura nga interesat e depozitës të përbashkët me bashkeshortin në Intesa San Polo, 53 793 Lek.

Të ardhura Qiradhënie Nuk ka

Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka

Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka

Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka

Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshorti, të ardhura nga honoraret si gazetar, 3 750 000 Lek
- 2) Bashkëshorti, të ardhura nga interesat në Raiffeisen Invest, 199 197 Lek.
- 3) Bashkëshorti, të ardhura nga honoraret për shërbime konsulcece pranë Bankës së Shqipërisë, 399 000 Lek.
- 4) Bashkëshorti, të ardhura nga honoraret nga Fakulteti Histori-Filogjii, 58 476 Lek.
- 5) Bashkëshorti, të ardhura qiraje nga dy apartamente, 540 000 Lek.

Të ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

- 1) Shtesë me 1 857 Euro në llogarinë e përbashkët në La Banque Paris, për efekt të kalimit të fondeve nga depozita personale PEL brenda bankës.
- 2) Pakësim me 113 Euro depozita e përbashkët në La Banque Paris për efekt të transferimit të fondeve në llogari personale brenda bankës.
- 3) Shtesë me 974,042 Lek në llogarinë e përbashkët në Intesa san Paolo Bank, nga rroga dhe honorare të bashkeshortit si dhe interesa depozite brenda bankës.
- 4) Pakësim me 18 Euro në llogarinë e përbashkët në Societe Generale Bank.
- 5) Shtesë me 1 775 Euro në fondin e përbashkët të pensionit CPIC i krijuar prej vitit 1991, për konsulentë dhe ekspertizë.
- 6) Shtesë me 1 325 121 Lek në llogarinë e përbashkët në Raiffeisen Bank, nga paga dhe pagesa të funksionit si Ministër.
- 7) Pakësim me 12 Euro në llogarinë e përbashkët në Procredit Bank.
- 8) Bashkëshorti, shtesë me 538 444 Lek në llogarinë pranë Credins Bank, nga honoraret dhe kalimi i fondeve nga depozita brenda bankës.
- 9) Bashkëshorti, pakësim me 506 972 Lek në depozitën Credins Bank, për kalim fondesh në llogarinë personale brenda bankës.
- 10) Bashkëshorti, shtesë me 580 391 Lek në llogarinë personale në Raiffeisen Bank, nga pagesa qiraje dhe kalim fondesh nga llogaria brenda bankës nga bashkëshortja, për shpenzime jetese dhe shlyerje kredisë.
- 11) Bashkëshorti, pakësim me 8 950 USD në llogarinë personale në NBG.
- 12) Bashkëshorti, shtesë me 2 500 000 Lek në llogarinë personale në Societe Generale, nga kalim fondesh nga llogaria personale pranë Intesa San Paolo Bank.
- 13) Bashkëshorti, shlyer vlera prej 384 000 Lek për kredinë me vlerë 2 000 000 Lek pranë Raiffeisen Bank, gjendja e të cilës në 31 Dhjetor 2017 është 2 181 219 lek



Blendi KLOSI

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 2015-05-29
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 01.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet

- 1) Të ardhura nga paga si Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për periudhën Janar-Mars, 363 693 Lek.
- 2) Të ardhura nga paga si Ministër i Turizmit dhe Mjedisit për periudhën Shtator-Dhjetor, 478 627 Lek.
- 3) Të ardhura nga paga si Deputet i Kuvendit të Shqipërisë për periudhën Mars-Shtator, 879 209 Lek.

Të ardhura nga Bonuse Nuk ka

Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh

- 1) Të ardhura si Kryetar i Këshillit Administrativ në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, 25 395 Lekë.
- 2) Të ardhura nga pjesëmarrja në KKRT (Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit), 34 000 Lekë.

Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Nuk ka

Të ardhura Qiradhënie Nuk ka

Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka

Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka

Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka

Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare Bashkëshortja, të ardhura nga

paga si punonjëse në Televizionin Klan, 1 188 000 Lek.

Të ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka

Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

- 1) Shtesë me 548 540 Lek në llogarinë pranë Bankës Credins, nga të ardhurat e pagës mujore. Gjendja e llogarisë në 31 Dhjetor 2017 është 826 279 Lek.
- 2) Shtesë me 91 153 Lek në llogarinë pranë Raiffeisen Bank, për pagesën e kredisë të apartamentit me të ardhurat e pagës mujore. Gjendja e llogarisë në 31 Dhjetor 2017 është 289 523 Lek.



Damian GJIKNURI

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 11.10.2013
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste
Të ardhura nga Paga dhe Shpërblym Të ardhura neto nga paga si Ministër i Infrastrukturas dhe Energjisë, 1 560 597 Lek.
Të ardhura nga Bonuse Nuk ka
Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka
Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Të ardhura nga interesat në llogarinë e kursimit pranë Intesa San Paolo, 36 000 Lek.
Të ardhura Qiradhënie Nuk ka
Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka
Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka
Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka
Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare Bashkëshortja, të ardhura nga aktivitetet tregtare si administratore dhe ortak e vetme në 2 subjekte (si person fizik me NIPT L31309019L dhe si Sh.p.k me NIPT L61717029E) dhe paga si administratore e një subjekti privat, 9 100 000 Lek.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion Të tjera
Të tjera
 1) Shtesë me 2 001 Lek në llogarinë personale pranë Raiffeisen Bank për shlyerje borxhi.
 2) Shtesë me 493 866 Lek në llogarinë personale pranë Raiffeisen Bank nëpërmjet kthimit të borxhit nga të tretë dhe transferës nga llogaria personale pranë Credins Bank, me qëllim shlyerjen e kredisë.
 3) Pakësim me 1 687 000 Lek në llogarinë personale pranë Credins Bank.
 4) Mbyllje e kredisë të mëparshme në Lekë pranë Raiffeisen Bank.
 5) Bashkëshortja, shtesë me 22 426 Euro në llogarinë personale në Raiffeisen Bank.
 6) Bashkëshortja, shtesë me 448 555 Lek në llogarinë personale në Raiffeisen Bank.
 7) Bashkëshortja, pakësim me 11 332 Lek në llogarinë personale në Raiffeisen Bank.
 8) Bashkëshortja, shlyer shuma prej 5 090 Euro për kredisë e marrë në Credins Bank.
 Detyrimi i mbetur në datën 31 Dhjetor 2017 është 23 121 Euro.
 9) Subjekti nuk deklaroi statusin e detyrimit të mbetur në 31 Dhjetor 2017 për pagesën e apartamentit të banimit me sipërfaqe 139.5 m² të porositur në vitin 2016 me vlerë 271 450 Euro, për të cilin në vitin 2016 është paguar kësti i parë prej 100 000 Euro.



Etilda GJONAJ

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.04.2014
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 13.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur E pavarur
Të ardhura nga Paga dhe Shpërblym
 1) Të ardhura neto nga paga gjatë periudhës Shtator-Dhjetor si Ministre e Drejtësisë, 468 554 Lek.
 2) Të ardhura nga paga gjatë periudhës Maj-Shtator si Zv.Ministër i Drejtësisë, 432 767 Lek.
 3) Të ardhura nga paga gjatë periudhës Janar-Maj si Komisioner Avokati i Popullit, 609 649 Lek.
 4) Të ardhura me vlerë 235 824 Lek, Avokati i Popullit si pagesa kalimtare Urdhr Nr.124 datë 26.07.2017.
 5) Të ardhura me vlerë 3 048 Euro si pagesa ekspertize dhe hartim manuali nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, periudha Shkurt-Maj.
 6) Të ardhura me vlerë 795 Euro si pagesa ekspertize nga OSCE gjatë muajit Mars.
 7) Të ardhura me vlerë 147 560 Lek, nga pagesa ekspertize për Reformën në Drejtësi si Eksperte pranë Sekretarit Teknik të Komisionit të përkohshëm të Reformës në Drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me fondacionin Soros në Prill 2017.
 8) Të ardhura me vlerë 7 000 Lek nga dieta brenda vendos në pozicionin Ministër i Drejtësisë.
Të ardhura nga Bonuse
 1) Të ardhura me vlerë 54 546 Lek nga kompensimi bonus transporti, në pozicionin Zv. Ministër i Drejtësisë.
 2) Të ardhura me vlerë 10 000 Lek nga pagesë shërbim telefonik nga pozicioni Avokat i Popullit
Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh
 1) Të ardhura me vlerë 51 000 Lek nga pjesëmarrja në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Territorit.
 2) Të ardhura me vlerë 42 500 Lek si anëtar e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Nuk ka
Të ardhura Qiradhënie Nuk ka
Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka
Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka
Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka
Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare Bashkëshorti, të ardhura me vlerë 387 907 Lek nga paga si i punësuar pranë shoqërisë '23 Option' Sh.p.k me NIPT L62025015J, për periudhën Janar-Korrik 2017.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion
Të tjera
 1) Pakësim me 2,05 Euro i llogarisë bankare depozitë pa afat pranë Credins Bank.
 2) Bashkëshorti, shlyer shuma prej 137 400 Lek për principalin, interesat dhe kamatonesat e kredisë me vlerë 500 000 Lek me afat 5 vjeçar, marrë në Alpha Bank në datë 10.12.2013. Gjendja e detyrimit në 31 Dhjetor 2017 është 127 159 Lek.
 3) Bashkëshorti, shlyer shuma prej 75 050 Lek për principalin, interesat dhe kamatonesat për kredisë me vlerë 250 000 Lek me afat 5 vjeçar marrë në Alpha Bank në datë 21.01.2014. Gjendja e detyrimit në 31 Dhjetor 2017 është 71 067 Lek.
 4) Bashkëshorti, shitje e aksioneve të shoqërisë '23 Option' Sh.p.k me vlerë 10 000 Euro, në bazë të kontratës datë 28.07.2017.



Fatmir XHAFAJ

Funksioni dhe institucioni Deputet i Parlamentit - Kuvendi i Shqipërisë
Koha e marrjes së detyrës/mandatit Legjislatura V, VI, VII, VIII
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 13.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste
Të ardhura nga Paga dhe Shpërblym
 1) Të ardhura neto me vlerë 756 486 Lek nga paga, shpërblime dhe rimbursim shpenzimesh nga pozicioni si Ministër i Brendshëm.
 2) Të ardhura neto me vlerë 970 398 Lek nga paga, shpërblime, komisione të përhershme dhe komisione të përkohshme etj., nga Kuvendi i Shqipërisë.
 3) Të ardhura neto me vlerë 180 Euro si rimbursimi fondesh nga udhëtimi në Kroaci nga Komisioni i Ligjeve.
Të ardhura nga Bonuse Nuk ka
Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka
Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Të ardhura neto nga interesat me vlerë 18 781 Lek, nga dy depozitat pranë Credins Bank, të çelura përkatesisht në datat 11.12.2013 me afat maturimi 1 vjeçar dhe 18.12.2015 me afat maturimi 1 vjeçar.
Të ardhura Qiradhënie Të ardhura neto për vitin me vlerë 13 770 Euro, nga dhënia me qira e dyqanit në Vlorë për Procredit Bank, sipas kontratës me datë 17.06.2015.
Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka
Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka
Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka
Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare
 1) Bashkëshortja, të ardhura neto të vitit me vlerë 1 344 167 Lek nga fitimi i realizuar nga ushrimi i aktivitetit të Noterit.
 2) Vajza, Znj.Aulona Xhafaj, të ardhura neto me vlerë 745 450 Lek nga paga, shpërblime dhe skemë e kursimit si punonjëse në Intesa San Paolo Bank.
 3) Vajza, Znj.Aulona Xhafaj, të ardhura me vlerë 166 544 Lek nga përfitimet nga leja e lindjes.
 4) Vajza, Znj.Amantia Xhafaj, të ardhura neto me vlerë 28 268 Euro nga punësimi në PRICEWATERHOUSECOOPERS S.P.A.Milano.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion
Të tjera
 1) Pakësim me 225 Euro në llogarinë pranë Raiffeisen Bank.
 2) Pakësim me 295 203 Lek në llogarinë pranë Credins Bank.
 3) Pakësim me 10, 41 Euro në llogarinë në Credins Bans.
 4) Pakësim me 11,56 USD në llogarinë në Credins Bank.
 5) Shtesë me 13 770 Euro në llogarinë rrjedhëse në Procredit Bank nga qiradhënia, e përshkruar në seksionin Të ardhura nga qiradhënia.
 6) Pakësim me 41,25 Euro në llogarinë rrjedhëse në Alpha Bank.
 7) Pakësim me 600 Lek në llogarinë rrjedhëse në Alpha Bank.
 8) Pakësim me 1 500 000 Lek i gjendjes cash për mbulimin e shpenzimeve.
 9) Shlyer shuma prej 32 241 Euro për kredisë për bleje apartamenti në Tiranë, me vlerë 100 000 Euro dhe afat 15 vjet. Kredia është çelur në datë 18.07.2006 dhe është mbyllur në vitin 2017, një pjesë e të cilës është paguar nga bashkëshortja (shiko pikën 11.).
 10) Bashkëshortja, shtesë me 3 304 250 Lek në llogarinë rrjedhëse në BKT, nga shitja e pronës në Pogradec në bashkëpronësi me të afërm.
 11) Bashkëshortja, pakësim me 18 018 Euro i llogarisë rrjedhëse në BKT, për mbylljen e kredisë në emër të Bashkëshortit pranë Alpha Bank.
 12) Bashkëshortja, përfituar dy apartamente me sipërfaqe 69 m² dhe 76 m² përkatësisht, në datë 16.05.2017 si burim shkëmbim truall sipas kontratës me datë 06.05.2017.
 13) Bashkëshortja, shitje apartamenti me vlerë 3 300 000 Lek, me sipërfaqe 64.5 m², i përfituar si shkëmbim truall sipas kontratës me datë 06.08.2016 dhe kontratës të këmbimit në datë 06.05.2017. Apartamenti është regjistruar pranë ZRRP Pogradec në datë 16.05.2017.
 14) Bashkëshortja, të ardhura me vlerë 14 000 Euro nga kthimi i huasë të marrë nga motra e bashkëshortit.
 15) Vajza, Znj.Aulona Xhafaj, shtesë me 453 952 Lek në llogarinë rrjedhëse të pagës në Intesa San Paolo Bank.
 16) Vajza, Znj.Amantia Xhafaj, pakësim me 10 Euro në llogarinë rrjedhëse në Credins Bank.
 17) Vajza, Znj.Amantia Xhafaj, shtesë me 3 752 Euro në llogarinë bankare në Intesa San Paolo Milano



Ditmir BUSHATI

Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 15.09.2013
Funksioni dhe institucioni Këshilli i Ministrave PS mandati II - Këshilli i Ministrave
Koha e marrjes së detyrës/mandatit 10.09.2017
Perfaqësues politik/i pavarur Partia Socialiste
Të ardhura nga Paga dhe Shpërblym Të ardhura nga paga si Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, 1 560 597 Lek.
Të ardhura nga Bonuse Nuk ka
Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh Nuk ka
Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies Të ardhura nga interesat e depozitës pranë Credins Bank, 32,88 Euro.
Të ardhura Qiradhënie Nuk ka
Të ardhura nga Bizneset dhe Sipërmarrjet individuale Nuk ka
Të ardhurat nga Ortakëri/Aksione Nuk ka
Të ardhura nga Publikimet dhe e drejta e Autorit Nuk ka
Të ardhura nga Çelje Trashëgimi Nuk ka
Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare
 1) Bashkëshortja, të ardhura nga puna si konsulente dhe trajnere në Institutin Shqiptar për Inovacion Social, Shkollën e Administratës Publike dhe Shkollën e Magjistraturës, 426 256 Lek.
 2) Bashkëshortja, të ardhura si konsulente nga projektet e Këshillit të Evropës në Shqipëri dhe Kosovë, 29 722 Euro.
 3) Bashkëshortja, të ardhura nga puna si konsulente në Institutin ACER, 1 200 USD.
Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë Nuk ka
Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion
Të tjera
 1) Shtesë me 642 363 Lek në llogarinë rrjedhëse në Credins Bank, shtuar nga paga si Ministër.
 2) Bashkëshortja, shtesë me USD 1 200 në llogarinë rrjedhëse në Intesa San Paolo Bank, nga puna si konsulente.
 3) Bashkëshortja, shtesë me 27 372 Euro në llogarinë rrjedhëse në Intesa San Paolo Bank, nga puna si konsulente.
 4) Bashkëshortja, shtesë me 9 350 Euro në llogarinë rrjedhëse në Intesa San Paolo Bank, nga dietat e projekteve dhe mbyllja e llogarisë në Raiffeisen Bank.
 5) Bashkëshortja, pakësim me 14 700 Euro dhe mbyllje e llogarisë në Raiffeisen Bank.
 6) Bashkëshortja, shtesë me 56 706 Lek në llogarinë rrjedhëse në Intesa San Paolo Bank, nga puna si trajnere me Shkollën e Administratës Publike dhe Shkollën e Magjistraturës.
 7) Bashkëshortja, shtesë me 369 550 Lek në llogarinë rrjedhëse në Intesa San Paolo, nga puna si konsulente.

Emri i Maqedonisë, OSBE: Marrëveshja zgjidh problemet e rajonit

Hahn: Besoj se BE do të çelë negociatat për Maqedoninë

Opozita greke mocion mosbesimi kundër Ciprasit

Ndërsa dje pritej që të miratohej emri i Maqedonisë në qeveri, ka reaguuar kreu i opozitës së djathtë greke. Kyriakos Mitsotakis njoftoi dje se do të depozitonte një mocion mosbesimi kundër qeverisë së kryeministrit, Aleksis Cipras, për të bllokuar marrëveshjen e arritur mes Athinës dhe Shkupit për emrin e Maqedonisë. Duke u shprehur para parlamentit, Mitsotakis theksoi se ky mocion mosbesimi kundër qeverisë do të depozitohet pasdite, pas votimit të paketës së fundit të masave të kërkuara vendit nga kreditorët BE dhe FMN. "Ne do të shohim nëse ka 154 deputetë nga 300 për t'i thënë 'po' nënkrimin të marrëveshjes së arritur mes Ciprasit dhe homologut maqedonas Zoran Zaev", theksoi Mitsotakis, shkruan ATSH. Nga kjo përgjigje, kreu i partisë konservatore "Demokracia e re" synon të testojë kohezionin qeveritar, i rrezikuar për kompromisin me Shkupin nga qëndrimi i aleatit sovranist të Ciprasit, Panos Kammenos. Ndërkohë, eurokomisioneri për Zgjerim dhe Politikë të Mirë Fqinjësore, Johannes Hahn në një intervistë për MIA-n shpreh bindjen se Këshilli i BE-së këtë muaj do t'i ndajë Maqedonisë datë për fillimin e negociatave për anëtarësim. Hahn në një intervistë për agjencinë 'Mia' flet për pritjet e tij nga Këshilli i BE-së, për atë nëse ekzistojnë rreze që vendi të mos fitojë datë për negociatat, për përpjek-



Johannes Hahn

ENZO MOAVERO:

"Kjo është një mundësi unike që duhet të shfrytëzohet dhe ndërtohet më tej. Kjo marrëveshje historike tani mund të shpë në një zgjidhje afatgjatë për të mirën e të gjithë qytetarëve dhe rajonit në tërësi", - tha sekretari i Përgjithshëm Greminger.

jet e KE-së që t'i bindë ato vende anëtare, të cilat e kundërshtojnë këtë proces, por edhe për gjendjen e brendshme politike në vend pas publikimit të marrëveshjes me Greqinë, gjegjësisht për qëndrimet

e presidentit Gjorge Ivanov dhe VMRO-DPMNE-së opozitare. "Nëse e gjitha kjo tani është nënkruar dhe dakorduar se do të ketë impakt në konkluzionet e Këshillit, pres që, pas rekomandimit për

negociatat, të fillojnë përgatitjet për fillimin e negociatave", - ka thënë eurokomisioneri Hahn. Nga ana tjetër ka reaguuar edhe kryesuesi i OSBE-së, ministri i Jashtëm i Italisë, Enzo Moavero Milanesi, dhe Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, Thomas Greminger, përshëndetën njoftimin mbi marrëveshjen për zgjidhjen e çështjes së emrit ndërmjet Athinës dhe Shkupit, të cilën e vlerësuan si një hap të madh drejt avancimit të stabilitetit rajonal.

JOHANNES HAHN:

"Nëse e gjitha kjo tani është nënkruar dhe dakorduar, se do të ketë impakt në konkluzionet e Këshillit, pres që, pas rekomandimit për negociatat, të fillojnë përgatitjet për fillimin e negociatave," ka thënë eurokomisioneri Hahn.

"Urime kryeministrave Alexis Tsipras dhe Zoran Zaevit për udhëheqjen dhe angazhimin e tyre ndaj këtij procesi të rëndësishëm për të dy vendet, për Europën Juglindore dhe për Europën në tërësi", tha Kryesuesi Moavero. "Kjo është një mundësi unike që duhet të shfrytëzohet dhe ndërtohet më tej". Sekretari i Përgjithshëm Greminger theksoi rëndësinë e dialogut dhe kompromisit në këtë proces. "Kjo marrëveshje historike tani mund të shpë në një zgjidhje afatgjatë për të mirën e të gjithë qytetarëve dhe rajonit në tërësi", ka thënë Moavero.

SHKURT

Masakra me 4 fëmijë të vrarë, në koma oficeri i plagosur

Një pengmarrje, e cila vijoi për 23 orë përfundoi në tragjedi të martën, në Florida të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Një burrë qëlloi për vdekje 4 fëmijë përpara se të drejtonte armën nga vetja. Sipas BBC, policia e gjeti 35-vjeçarin Gary Wayne Lindsey të vdekur në apartamentin ku po mbante peng fëmijët, të moshës 1 deri në 12 vjeç, në Orlando. Lindsey ishte babai i dy prej fëmijëve, ndërsa dy fëmijët e tjerët ishin të së dashurës së tij. Ai ishte një i dënuar në liri me kusht, për disa akuzat, ndër to edhe zjarrvënien të qëllimshme. Kishte qenë e dashura e 35-vjeçarit që kishte njoftuar policinë, pasi ai e kishte dhunuar. Katër viktimat e kimit të tij makabër janë Iraya, 12 vjeç, Lillia 10, Aidan, 6, dhe Dove, vetëm 1 vjeçe. Por si të mos mjaftonte kjo ngjarje tragjike, gjatë tentativës për të liruar fëmijët, një oficer policie mbeti i plagosur rëndë. Ai ndodhet në gjendje kome në spital dhe rikuperimi i tij pritet të jetë i vështirë. Gjatë 23 orëve pengmarrje, teksa negocionin me Lindsey për lirin e fëmijëve, oficerët nuk dëshuan në asnjë moment se të miturit kishin vdekur, derisa dalluan një prej tyre pajetë.

Trump vendos, SHBA s'heq sanksionet ndaj Koresë së Veriut

Koreja e Veriut do të vijojë të vuajë sanksionet e rënda ekonomike të Shteteve të Bashkuara deri në asgjësimin e plotë të arsenalit bërthamor. Këtë e bëri të qartë sekretari amerikan i shtetit Mike Pompeo, i cili foli gjatë një konference për shtyp në Seul. "Lehtësimi i sanksioneve nuk mund të ndodhë deri kur të na jenë paraqitur fakte se Koreja e Veriut është denuklearizuar plotësisht." Në këtë mënyrë Pompeo hodhi poshtë lajmet që qarkulluan nga mediat shtetërore të Penanit, pas takimit historik të Singaporit me Kim Jong-un dhe Donald Trumpit. Përmes Twitterit, shefi i Shtëpisë së Bardhë tha se pas kthimit nga Singapori se kishte bërë të paimagjinueshmen duke shmangur luftën bërthamore me Korenë e Veriut, që deri pak muaj më parë konsiderohej e sigurt. Por ekspertët ushtarakë e gjykojnë si jo tepër pozitiv rezultatin e samitit. Sipas tyre, Trump lëshoi më shumë se ç'mori në këmbim nga Kim Jong-un.

Agjencia 'Beta': Gjetën orën e këputur dhe celularët e fikor

Publikoi fotot e të dyshuarve, zhduket gazetari serb që hetonte vrasjen e Ivanoviçit

Stefan Cvetković, gazetari që po hetonte vrasjen e Oliver Ivanoviçit, zhduket në mënyrë të papritur. Makina e Cvetković u gjet e hapur mbrëmjen e të martës në Bela Crkva të Serbisë. "Stacioni i policisë në Bela Crkva është njoftuar se në Rrugën e Beogradit në Bela Crkva ka gjetur një automjet të parkuar të markës 'Polo' në pronësi të babait të tij, në të cilin dera e shoferit ishte e hapur", njofton Ministria e Brendshme e Serbisë. Gazetari Cvetković gjatë kësaj kishte mbajtur një

MINISTRIA E BRENDSHME E SERBISË:

"Stacioni i policisë në Bela Crkva është njoftuar se në Rrugën e Beogradit në Bela Crkva ka gjetur një automjet të parkuar të markës 'Polo' në pronësi të babait të tij, në të cilin dera e shoferit ishte e hapur", -njofton Ministria e Brendshme e Serbisë.

konferencë shtypi në të cilën kishte thënë se ai ishte mbajtur gjashtë orë në pikën kufitare në Jarinë dhe se pas kësaj, nga Policia e Kosovës kishte marrë dokumentin në të cilin konfirmohet se ai ishte me urdhër të prokurorit special që

udhëheq hetimet për vrasjen e politikanit Oliver Ivanoviçit. Gazetari në atë kohë kishte thënë se në Kosovë kishte shkuar me punë gazetarie sepse, siç kishte deklaruar ai, po punonte në hulumtimin e vrasjes së Oliver Ivanoviçit. Në muajin



Stefan Cvetković

shkurt në Beograd ai kishte mbajtur një konferencë për shtyp ku kishte shfaqur fotografite e njerëzve, të cilët, siç thoshte ai, dyshohet se ishin të përfshirë në vrasjen e liderit të Iniciativës Qytetare Serbe SDD, Policia njoftoi se kishte nisur kërkimet dhe se prokuroria ishte informuar për incidentin. Siç tregon 'Beta', dëshmitarët okularë kanë thënë se

ora e dorës e Cvetković u gjet e këputur. Agjencia 'Beta' u përpoq të komunikonte me Cvetković, por të gjithë telefonat celularë ishin shkëputur. Shoqata e Pavarur e Gazetarëve Serbë dhe Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës tha se policia duhet të ndërmarrë kërkime më intensive për zhdukjen e gazetarit.

DEBATI PËR TEATRIN

SHEMBJA E TEATRIT KOMBËTAR

Ndrenika, Veliajt: Jo teatër me PPP.

Arbana: Kullat do na bien mbi kokë

Artistët kundërshtojnë tjetërsimin e pronës së teatrit: Asnjë bisedim për shembjen e tij

Veliajt qëllon me vezë, kryetari i bashkisë: Nuk keni shenjë, s'më kapi asnjë nga 10 vezët

Fatmira Nikolli

Pas katër muajsh protestë për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar, artistët janë pritur dje në një dëgjese nga kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliajt. Në hyrje të hotelit ku do mbahej takimi, ai u qëllua me vezë nga të rinjtë e FRPD-së, por asnjë prej tyre nuk e kapi. Përkrah tij, për dy orë e heshur, qëndroi edhe ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, që në këtë proces ka qenë më shumë zbatuese se vendimtarëse. "Kuvendi" për një teatër pa kulla siç e kërkojnë artistët, u mbajt brenda një kulle në qendër të Tiranës, për të cilën kontestimet kanë qenë të hershme. Ndërsa salla që mbushur veç artistëve të qëndrës, edhe nga artistët e TKOB, të cilëve përmes një e-maili iu ishte thënë se kanë takim me ministrin dhe Veliajt, ndonëse në këtë debat, opera as baleti, nuk kanë vend. Po aty, qëndronin edhe një pjesë e punonjësve të Ministrisë së Kulturës.

Kryetari i bashkisë në fjalën e tij u shpreh se gjendja aktuale e teatrit është e mjerueshme. "Sipas vlerësimeve tona, ndërtimi i teatrit shkon 4-5 fishi i një palati. Me çmimet e Shqipërisë për 9500 m², kostoja do të shkonte 30 milionë euro. A janë shumë apo janë pak? Të gjitha investimet që ju shikoni në Tiranë në një vit janë në nivelin e 20 milionë eurove. Çdo gjë që ndodh në Tiranë, të gjitha investimet, kopshta, çerdhe, pemë, kanalizime, bujqësia, emergjenca civile, të gjitha kushtojnë kaq. Nga viti 2005-2013 janë harxhuar 1.8 miliardë lekë ose 18 milionë USD për kulturën. Nga qeveria e re në 5 vite 15 milionë USD", tha ai. Më pas, tha se kish ardhur të bënte një ofertë.

"Dua t'u bëj një ofertë shumë të sinqertë. Nëse jeni dakord që të caktoni një përfaqësi që t'i bashkohet ekipit tim dhe të negociojmë. Nëse nuk na pëlqen, e lëmë. Ne na duhet një gjë e re. Se si, hajt ta flasim. Ky nuk është një ligj për të prishur teatrin, nuk është një ligj për të ndërtuar një teatër të ri. Ne siç thonë tiranasi na ka ardhur zogu në dorë. Kështu, të bëhemi bashkë dhe të negociojmë me arkitektin. Nëse funksionon amin, nëse nuk funksionon, hajde të vrasim mendjen".

Pas tij, fjalën e morën artistët. 'GSH' po zbardh të plota fjalët e atyre që folën dje në këtë takim.

ALERT ÇELOALIAJ

Argumentet tona janë edhe të njohura. Ideja për teatër të ri nuk është ide e re, është mbi 20-vjeçare. Problemi nis të ftesa, ftohemi për të diskutuar e na thuhet që teatrin i ri do të ndërtohet në të njëjtin vend, pra është e kryer, ndaj nuk e

kuptoj se pse jemi ftuar sot. Na thuhet që do jetë aty ku është, na thuhet nuk do jetë multifunkionale, por nuk thuhet nëse pas tij do ketë kulla, a do jepet territori i teatrit për kulla. Thuhet s'do harxhohen para, por është PPP dhe diçka do i jepet privatit. Një sipërfaqe prej 1200 metrash thuhet në ftesë, por sipërfaqja e teatrit është mbi 7 mijë metra. Nuk e di pse është ky keqkuptim. Çdo gjë është në të kryerën. Nuk ka gjë për diskutim. Ne e kemi bërë për propozim për ta shpallur monument kulture. Teatri duhet të jetë në qendër. Do jemi kundër shembjes së TK dhe ruajtjes së hapësirës territoriale.

MIRELA JORGO(AVOKATE)

Ju dëgjova gjysmë ore, bëre propagandë të Tiranës. Nuk e caktoni ti axhendën.

ERION VELIAJ

Sot e kanë fjalën e artistët. Ia dhamë fjalën Robertit. Sillu në Tiranë si qytetare. Është e para e një serie dëgjësash. I lëmë aktorët të bëjnë aktorët.

ROBERT NDRENIKA

Faleminderit ju dhe Metës që bëri thirrje për gjakftohtësi dhe për të dëgjuar njëri-tjetrin.

Kam vuajtur shumë gjatë kësaj kohe, kam qenë të zyra e kryetarit më ka paraqitur projektin, kam qenë optimist, kam dëgjuar, por edhe kam vuajtur shumë nga çështja e Partneritetit Privat-Publik. Ajo nuk ma heq njeri nga mendja se ka hile brenda. Kam vuajtur edhe personalisht, sepse e dhashë shtëpinë të një Partneriteti Publik-Privat dhe kam vuajtur 3 vjet gjyqe. Më thoshin gjykatësit, ty ta kanë bërë këtë more? Ma pushtuan edhe një hyrje, ma pushtuan hyrjen me bodigardët e vet. Vajta të ministri i Brendshëm, shoku Petro Koçi, që s'ma vari fare, kupton, tre vjet gjyqe, prandaj jam kundër Partneritetit Publik Privat. Ndoshta ai projekt që ka paraqitur ai holandezi është i mirë, skenën nuk e kam parë, jam në mëdyshje për çështjen e skenës dhe e kam thënë, nëse tërë teatri është 4/4, e ¼

është salla, ¼ është skena. Këtu ka dushe, ka kështu e ka ashtu, por skenën nuk e kemi parë, për këtë duhet të flasim regjisorët, arkitektët dhe aktorët. Mirë më bëre që përmende Pazarin e Ri i dasur kryetar, nuk ka ndonjë gjë të keqe të gjykohej e të arsyetohet, se siç është ai Pazar i Ri që e kam parë, që e ruan atë strukturë, po nuk është më as era e keqe, as qerpiçi por e ndjen që je te pazari i ri i dikurshëm, por që është i rregulluar. Kjo Zamira (Kita) mund ta na thotë që është edhe një Pazar i Korçës, por është bërë i shkëlqyer, të ka lezet shpirti ta shohësh, atje s'kam qenë, por më pëlqen shumë. Edhe ky kompleksi ynë, me të dyja këto godinat, por edhe me atë të marangozëve dhe me oborrin se është monument kulture, edhe me pishinën, mund të riparohet dhe të dalë një gjë e shkëlqyer, por jo me 30 milionë euro. E kam bindjen zoti Erion se të kanë gënjyer me ato 30 milionë eurot, pavarësisht se the 4-5 fish, maksimumi venë 10 milionë euro ai që duhet të bëjmë. Nuk është e vërtetë ajo. Maksimumi mund të shkojë deri në 10-15 milionë euro, ai teatër që duan të bëjnë.

Megjithatë, ky kompleksi teatror që e quajnë dopolavoro... Kjo dopolavoro, thuhet me qëllim për të zhyer gjithë historinë, hiqni këtë fjalën dopolavoro tani drejt e marrtë, pas 70 vjetësh nuk konvenon më. Mendoj edhe e kam pjekur këtë mendim gjatë kësaj kohe. Se nuk kam qenë dakord as me këta djemte, që më thoshin trashëgimia kulturore, trashëgimia mund të ruhet si të Varrezat e Dëshmorëve, ku në një pllakë thuhet këtu ka qenë varreza. Por, tani më është konsoliduar mendimi që gjithë ai kompleksi i teatrit është një gjë që mund të ruhet dhe për këtë, shembull kam edhe Pazarin e Ri të Tiranës edhe atë të Korçës. Në këtë drejtim, Kiço Londo është duke dhënë një shembull shumë të mirë, që e ka mirëmbajtur, e ka lyer e ka bërë mirë. Nëse s'jam i qartë për ndonjë gjë, unë prapë mendoj që Tirana e do një teatër të mirë, të ri, që mund të vejë 100 e 200 vjet si e kanë vendet e tjera të Ballkanit. Mendoj të bëhet ky lloj studimi i këtij lloj komplek-



Në foto: Robert Ndrenika

Kam vuajtur shumë nga çështja e Partneritetit Privat-Publik. Ajo nuk ma heq njeri nga mendja se ka hile brenda. Të bëhet një kompleks i tëri me pemët, me pishinat.

si. Aeroporti i Rinasit zoti kryetar nuk është gjë, me hekura e me xhama është. Të respektohet kompleksi.

ERION VELIAJ

Shkupi e ka bërë me 50 milionë, në Norvegji 170 milionë. Ato janë parametra e variabla që mund t'i diskutojmë.

ROBERT NDRENIKA

Jam interesuar edhe unë. Edhe kjo qendra tregtare këtu s'ka vajtur aq shumë. Kam pyetur njerëz unë. Aty në kafë rri, por pyes njerëz. Këtë maksimumin me 9 mijë metra katrorë që është e shumëzoi edhe me 3-fishin, s'më del më shumë se 15 milionë euro more. Megjithatë, në këtë varfëri që paska ky shtet shqiptar, i cili vetëm rrugën deri në Tiranë - tunel atje e ka paguar 4 herë, e ka paguar 4 herë dhe nuk është bërë akoma, shkon më mirë ky propozim që bëra unë, që të bëhet një kompleks i tëri me pemët, me pishinat.

ROBERT BUDINA

Ju luani shumë bukur, me ndjeshmërinë e shqiptarëve se duhen ndërtuar shkolla e spitale. Nëse nuk keni formuar njeri, ju mund të ndërtoni çdo gjë që doni, dhe njerëzit do të mbeten po aq të varfër sa ç'ishin, sepse njeriun bën kultura. Unë nuk e di se si i nxjerrin fjinjtë lekët për financime në kulturë. Shteti shqiptar ka 15 milionë euro për kulturën, 67 milionë euro ka Maqedonia për kulturën. Duhet të bjerë ky draft ligjor dhe të diskutojmë se kështu nuk e bëjmë dot. Trashëgimia nuk është llaç me tulla. Nuk e imagjinoj dot profesor Robertin në një ndërtesë futuriste. Në 20 vjet sa lekë i mbajtur kulturës? Me 200 milionë euro do ishin bërë të gjitha dhe nuk do kishite nevojë për tutoriatin e politikës. Tek ajo godina kanë lindur të gjitha institucionet



Në foto: Veliajt dhe Kumbaro dje

Opinion i Ditës

Real-politikë mbi çeljen e negociatave

Nga Rudina Hajdari

(Vijon nga faqja e parë)

...dhe paqes për të gjithë Ballkanin Perëndimor. Me bindje të plotë mendoj që është një ogur i mbarë edhe për Shqipërinë, sepse në të kundërt do të ishte një pengesë e përbashkët për çeljen e negociatave.

Ndërkohë, në rajon ka edhe zhvillime të tjera që mund të forcojnë peshën e argumenteve të krahut që është kundër çeljes së negociatave për Shqipërinë. Kështu për shembull, në Beograd ministër i Financave, i sapoemëruar, një ish-kryetar Bashkie i Beogradit, mbi të cilin rëndojnë akuzat serioze për korrupsion. Është qartësisht diçka që nuk ka të bëjë me Shqipërinë, por në Bundestag u diskutua se këto janë fenomene jo fort të mirëpritura.

Edhe pse ende në formësim e sipër qëndrimi gjerman lidhur me çeljen e negociatave për vendin tonë mbetet ende fraktare deri në javën e ardhshme, që do të zhvillohet samiti franko-gjerman, më datë 19 qershor, ku dosja shqiptare me siguri do të jetë pjesë e diskutimeve. Në këtë kuadër mund të thuhet se Gjermania do të marrë një vendim në lidhje me qëndrimin që do të mbajë për fatin e Shqipërisë për çeljen e negociatave.

Sipas të gjitha gjasave, rezultati më i favorshëm i vendimmarrjes gjermane në Bundestag do të jetë një qëndrim i tipit, "po... por me faza...". Nuk ka ende një kalendar të mirëpërcaktuar lidhur me "fazat" e sugjeruara. Por, ajo që mund të them është se këto faza do të mbështeten në zhvillimet e brendshme të Shqipërisë: si reforma e sistemit të drejtësisë, vetingu, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe reforma zgjedhore. Edhe në rast se marrim një "Po" negative, siç e kanë cilësuar disa prej zyrtarëve gjermanë, atëherë mbetet të presim që Gjermania të arrijë të bindë Francën, e cila duket e prerë në vendimin e saj për t'i thënë "Jo" çeljes së negociatave për vendin tonë. Ky qëndrim i Francës vjen si rezultat i problemeve të shumta brenda Bashkimit Europian, të cilat janë shumëfishuar edhe nga vendet që janë bërë pjesë e BE-së vitet e fundit.

Eksperiencat negative të Rumanisë, Bullgarisë,



Qipros, Sllovenisë e kanë bërë procesin dhe më rigoroz. Sidomos, konflikti Slloveni-Kroaci është një precentë e hidhur për vendet e BE-së dhe sa më shumë kohë kalon, aq më i vështirë dhe kërkuës bëhet procesi i integritimit.

Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së janë të bindura se anëtarësimi në BE është një përgjegjësi e madhe për një shtet, pasi vjen me ndryshime të shumta, që mund të kenë pasojë shumë të mëdha në harmonizimin e ligjeve dhe rregullave të tregut të përbashkët të BE-së. Këto përgjegjësi mund ta çojnë një vend në kolaps ekonomik apo në krizë sociale e si rrjedhojë, BE e

shikon sfidën e anëtarësimi si një përgjegjësi të madhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, për të cilët janë skeptikë nëse mund ta përballojnë sfidën e anëtarësimi. Por nga ana tjetër, Gjermania është e bindur se Ballkani Perëndimor është pjesë e Europës dhe procesi i integritimit është thejshet çështje kohe.

Gjithsesi, Shqipëria ndodhet në një situatë goxha të komplikuar para çeljes së negociatave dhe është shumë e vështirë të parashikosh se çfarë do të ndodhë në fund të qershorit. Politika e brendshme apo kundërpërgjigjet qeveritare ndaj opozitës në lidhje me qëndrimet e vendeve të

Bashkimit Europian kanë formën e një loje shahu. Përdorimi i opinionëve të ndryshme mbi qëndrimin e Shqipërisë për çeljen e negociatave është qesharak e plotësisht i dukshëm në sy të opinionit publik.

Qëndrimi i mazhorancës së për të dëshiruar, sepse nuk po tregon vullnet politik deri në vetësakrificë si Maqedonia, për të zgjidhur disa nga rezervat që kanë vendet anëtare të BE-së për Shqipërinë. Edhe pse Maqedonia e zgjidhi këtë problem shumëvjeçar, kjo ka polarizuar opinionin publik në Maqedoni. Në bazë krahasuese, vendi ynë fqinj, Maqedonia, po na jep mësim demokratike, sido-

mos me marrëveshjen e fundit me Greqinë dhe hapat që ka ndërmarrë vitin e fundit. Është shumë pozitive që Athina dhe Shkupi arritën në zgjidhjen e një çështjeje që ka ndikuar rajonin për vite me radhë e sidomos ka penguar integritimin e Maqedonisë në organizatat Euro-Atlantike. Avancimi i fqinjëve tanë drejt rrugës europiane është një e mirë për të gjithë rajonin.

Ndërkohë që qeveria "Rama" ka qenë selektive dhe e padrejtë në hapat e saj. Në fushat që ka dështuar, ia ka faturuar opozitës, duke mbajtur pozicionin e një qeverie që ka vetëm 1 vit që ka ardhur në pushtet ndërkohë të mos harrojmë


që ka 5 vjet që qeveris vendin. Mazhoranca është në dijeni të plotë se Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së janë duke i ndjekur nga afër zhvillimet e brendshme të Shqipërisë, sidomos në dy fusha kryesore 1) reformën në drejtësi dhe 2) luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të drogës dhe korrupsionit. Çdo vendim i qeverisë që ka lidhje me këto fusha janë tashmë shumë lart në radarin e këtyre vendeve dhe sado që qeveria "Rama" mundohet të sfumojë apo të hedhë hi mbi faktet që lidhen me këto dy fenomene, është një tentativë e kotë dhe kundërproduktive. Prandaj, mazhoranca duhet të pranojë që janë pikërisht faktet e mëposhtme, që kanë dëmtuar procesin e integritimit në BE, përballë secilës përgjigje të marrë Shqipëria, "Jo" ose "Po, negative" (me kushte).

1. Çështja kryesore dhe më e rëndësishme është ajo e reformës në drejtësi. Një proces që duhet të ishte më intensiv në syrin e ndërkombëtarëve dhe duhet vënë në dukje fakti shqetësues se vetëm 12 gjyqtarë nga 800 i janë nënshtruar vetingu në 6 muaj. Gjithashtu, rezultatet tregojnë se ne jemi në një gjendje mjeruese, duke marrë parasysh shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese si rezultat i vetingu, duke krijuar një boshllëk në sistemin për shkak të moszëvendësimit të tyre, gjë që e ka vënë këtë hallkë të sistemit të drejtësisë në krizë.

2. Çështja "Tahiri" kaq shumë e komentuar dhe e analizuar si brenda vendit, ashtu edhe nga ndërkombëtarët, u shndërrua në test për sistemin e drejtësisë. Ky sistem dështoi edhe njëherë me lirinë e tij nga arresti i shtëpisë.

3. Skandali "Xhafaj" është një shembull famëkeq për përpjekjen e qeverisë për të luftuar krimin e organizuar dhe trafikun e drogës. Sido që të jetë e vërteta, përfshirja direkte e një familjari të ministrit të Brendshëm me krimin apo trafikimin e drogës e vë ministrin në një pozicion vulnerabel dhe të gjithë institucionin që ai drejton.

4. Reforma zgjedhore është një tjetër çështje që do të monitorohet me kujdes nga ndërkombëtarët. Zbatimi i saj përpara zgjedhjeve lokale 2019 do të jetë si kaviat i rëndësishëm për çeljen e negociatave. Nëse nuk kemi rezultate në këtë fushë dhe rekomandimet OSBE/ODHIR nuk merren parasysh, atëherë do të krijohet një hendek tjetër për avancimin drejt BE-së.



Gjkata e Arbitrazhit Sportiv të Lozanës ka rrefuzuar kërkesën e Skënderbeut për pezullimin e dënimit të Apelit të UEFA-s, duke i mbyllur klubit korçar dyert e Kupave të Europës. Kështu, në Champions League do të shkojë ekipi i Kukësit, ndërsa Partizani shkon në Europa League. Gjithsesi, KAS ka pranuar padinë e Skënderbeut për gjyqin vendimtar kundër UEFA-s.

KAS rrëzon Skënderbeun! Gjykata e Arbitrazhit

Kukësi shkon në Champion, Partizani në Europa League

KAS rrëzon kërkesën e Skënderbeut, korçarët mbeten pa Europë

Sportiv në Lozanë ka refuzuar kërkesën e klubit korçar për pezullimin e efekteve të vendimit të Apelit të UEFA-s, me shpresën që të aktivizohet në Ligën e Kampioneve, por rrëzimi i padisë nga ana e KAS-it ja ka mbyllur këtë derë klubit korçar, i

cili fillon të ndjejë menjëherë efektet e dënimit 10 vjeçar, pasi këtë verë nuk do të marrë pjesë në Kupat e Europës. "Gjykata e Arbitrazhit Sportiv ka hedhur poshtë kërkesën për masa të përkohshme të kërkuara nga ana e Futboll Klub Skënder-

beut, në të cilin kërkohet të ndalej ekzekutimi i vendimit të dhënë nga ana e Komisionit të Apelit të UEFA më 26 prill të këtij viti".

Natyrisht që ky nuk është gjyqi përfundimtar, pasi fjalën e fundit KAS do ta thotë më vonë, atëherë kur të

do të shqyrtojë tërësisht dosjen e depozituar nga Skënderbeu. Vetë klubi korçar, në një reagim të mëpasshëm, kërkon ta sqarojë këtë pikë, duke theksuar se procesi gjyqësor ndaj UEFA-s është vetëm në hapat fillestare dhe se një vendim përfundimtar nga KAS do të merret në muajt në vijim.

Ky vendim i sotëm i KAS-it do të thotë se në Ligën e Kampioneve do të luajë skuadra e Kukësit, ndërsa Partizani do të luajë në verë në Ligën e Europës.

Organizatorët dhurojnë shou e gola në ndeshjen e parë të Kupës së Botës, duke kënaqur tifozët



Jeton Selimi

Rusia si një uragan, pesë gola Arabisë Saudite

Pesë gola dhe shumë klas, rusët në formë

Rusia e nis kampin onatin botëror me marshin e pestë. Skuadra e drejtuar nga trajneri Stanislav Çerçesov ka shpartalluar 5-0 Arabinë Saudite në një takim që u luaj praktikisht në të njëjtën portë. Rusët kanë dominuar e realizuar gola vërtet të bukur, për kënaqësinë e të gjithë të pranishmëve në stadiumin Luzhniki të Moskës. Madje e kanë nisur festivalin e golave shumë shpejt. Që në minutën e 12-të, kur në zhvillimet e një këndoreje, Gazinski shkëputet bukur në ajër dhe me kokë thyer portierin Al Muajuf. Rusia e fut në shinat e duhura shumë shpejt ndeshjen, por trajneri Çerçesov humbet në minutën e 24-të për shkak dëmtimi Alan Xagojev dhe në vend të tij hedh Denis Çerishev. Në minutën e 35-të vendësit pretendojnë një penallti, kur Golovin rrëzohet në zonë, por gjyqtari argjentinas Pitana, vijoi lojën. 2 minuta nga fundi i pjesës së parë do të vijë goli i qetësisë për rusët, kur Çerishev shërbehet mirë në zonë nga Zobnin dhe pasi shmgang me një finte dy mbrojtës, siluron portën saudite duke e çuar rezultatin e ndeshjes në 2-0 dhe duke



bërë që Rusia të shkojë e qetë në pushimin e ndeshjes. Me fillimin e pjesës së dytë, Arabia Saudite pati të vetmin moment për t'u rikthyer në ndeshje, kur Al Jasim nuk arrin të shtyjë në rrjetë një passim perfekt. Pas këtij momenti është vetëm Rusia. Në minutën e 68-të Zobnin, pronon të shënojë, por ndalet nga Al Muajuf, ndërsa 3

minuta më pas, nuk ka se çfarë të bëjë gardiani saudit në gjuajtjen me kokë të Xjubës, që çon rezultatin në 3-0. Arabia Saudite dorëzohet, ndërsa në minutat shtesë, Rusia do të realizojë dy gola vërtet të mrekullueshëm. Fillimisht me anë të Çerishev, që me të majtën shënon një perlë të vërtetë, ndërsa në limitet e sfidës, Golovin ekzekuton saktë

një goditje dënimi, duke e bërë të pavlefshëm fluturimin e Al Muajufit, ndërsa vulosi rezultatin 5-0, që i jep kryesimin e grupit A Rusisë, në pritje të sfidës së nesërme mes Egjiptit dhe Uruguajit.

STATISTIKA

Denis Çerishev është shpallur nga FIFA si lojtari i ndeshjes në përbaljes mes Rusisë dhe Arabisë Sau-

BOTERORI RUSI 2018		
Grupi A		
Të enjten	Rusi - Arabi Saudite	5-0
Të premtën	Egjipt - Uruguaji	14:00
Renditja	Skuadra	N P
	Rusia	1 3
	Egjipti 0	0
	Uruguaji	0 0
	Arabia	1 0
Grupi B		
Të premtën	Marok - Iran	17:00
	Portugali - Spanjë	20:00

botërorëve që hyn si zëvendësues në takimin çelës dhe shënon gol.

Por ky takim dhuroi dhe statistika të tjera. Rusia ka regjistruar fitoren e dytë më të thellë nga një vend pritës në ndeshjen hapëse të Botërorit në historinë e aktiviteteve pas asaj Itali-SHBA 7-1 në vitin 1934. Po ashtu, Rusia ka shënuar 3+ gola në një ndeshje Botërori për herë të parë që kur fituan 6-1 ndaj Kamerunit në vitin 1994. Artem Xjuba shënoi vetëm 89 sekonda pasi hyri në fushë, goli më i shpejtë nga një zëvendësues në Botëror që kur Marcin Zevlakov shënoi për Poloninë ndaj SHBA (64 sekonda) në vitin 2002. Juri Gazinski është lojtari i parë që shënon me gjuajtjen e parë në portë në një turne që kur Filip Lahm e bëri për Gjermaninë në vitin 2006, ndërsa Sergei Ignashevich (38 vjeç, 335 ditë) është lojtari më i vjetër që ka luajtur në një ndeshje Botërori që nga Roxher Milla në vitin 1994 (përfundimtar portierët).

ISH-TRAJNERI KUQEZI

Argjentina shihet si një nga Kombëtareset favorite për të fituar Botërorin e këtij sezoni. Megjithatë ka ende dyshime sa i përket një mundësie të tillë, pasi pavarësisht yjeve që kjo kombëtare ka në skuadër, mungesa e një grupi të bashkuar është një handikap i madh. Në një intervistë për mediat italiane, ish-trajneri i kombëtares shqiptare, Xhani De Biasi është shprehur se Argjentina

De Biasi: Argjentina fiton Botërorin nëse luan si Shqipëria ime

për të fituar Botërorin duhet të luajë, ashtu siç ka luajtur kombëtarja shqiptare në Europian. Ndërsa gazetari i ka vendosur në krahasim kombëtares shqiptare që drejtohej nga vetë ai dhe atë italiane që drejtohej nga Konte që luftonin si një ekip i vetëm, De Biasi ka thënë: "Njerëzorja mbetet gjithmonë baza

themelore. Ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë ka pasur gjithsesi ndryshime të mëdha dhe rezultatet e kanë bërë të qartë. Unë jam krenar për atë që kam bërë me Shqipërinë dhe them që në këtë Kupë Bote, Argjentina do të jetë në gjendje të bëhet fituese, nëse është një ekip i vetëm", ka thënë De Biasi.

"BOMBA" E DYTË

Mesfushori i Skënderbeut Sabjen Lilaj, ka folur për "Panorama Sport", pas vendimit të KAS, që nuk i ka dhënë të drejtën korçarëve të luajnë në Champions. "Fillimisht dua të them se më vjen keq për dënimin e Skënderbeut dhe vendimin e KAS. Por, unë e kam mbyllur me Skënderbeun pasi më ka skaduar kontrata dhe


Lilaj: Me Skënderbeun e kam mbyllur, Takaj të më paguajë!



klubit më ka disa detyrime. Ndoshta presidenti ka pritur këtë vendim, pasi unë

jam lojtar i lirë. I kam thënë presidentit që të më likuidoje financiarisht dhe ma ka shtyrë. Shpresoj të ndodhë shpejt. Për të ardhmen time, në ditë në vijim do të ketë zhvillime në lidhje me klubin ku do të luajë", ka thënë Lilaj.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Bëjnë arte me re.
- Krijoi Arsene Lupin (inic).
- Janë forma.
- Në hyrje të plazhit.
- Kapen të parat.
- Janë ufot.
- Mbahen nga ata që i thyejnë.
- Inicialet e Mascagni-t.
- Në krye të trupave.
- Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- Pak hemorrhagji.
- U shkrua nga Jack London.
- Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- Scarlet e Bashkë me erën.
- Janë tituj në ekran.
- Eric aktor.
- Kështu e ka syrin vigjilent
- Janë nofka.
- Një provë... inteligjence.

- Mund të jenë me sahat.
- Një pjesë e naivitetit.
- Pak imagjinatë.
- Pikat pa kufij
- Fillojnë aksionin.
- Kërkohej nga poetët.
- Nota e diapazonit.
- I prim kolonës.
- Eshtë filozofie moralit.
- Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- Malet pa kufij.
- Janë banorë imagjinare të planetit të kuq.
- Inicialet e Altman.
- Një sportist që arrin majat
- Courier ish-kampion i tenisit.
- Fillojnë testin.
- Mund të jetë parabolike.
- Bie me ballë.
- Carnera. ish-kampion i ringut.
- Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- I kanë rrejtë në tokë.
- Eshtë pushkë.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Takim Brezash Durrës.
- Ishte lumi i Elizit
- Eshtë kardinal.
- Mbyllin një krah.
- Artikull anglez.
- Mbyllin fushatit.
- Partia pa ara.
- Zola që shkroi Nana
- Nganjëherë duhen vënë mbi i.
- Një fjalë kastile
- Inicialet e Mann shkrimtar.
- Maiden që këndojnë.
- Ai i shtatë është kinemaja.
- Fillojnë arsyetimin.
- Eshtë nënë e Tironës.
- Eshtë shahu i fundit.
- Inicialet e Klee piktor.
- Dy asa.
- Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL:

- Patricia këngëtare.
- I vocërr ai i Migjenit
- Hari spiune.
- Qyteti i Robespierre.
- Phineas i famshëm i cirkut.
- Nota e diapazonit.
- Pak latinisht.
- Inicilet e Banderas.
- Janë tek në rrota.
- Pak efikasitet.
- Eshtë shkolla fillore.
- Arrihet duke aderuar
- Pak iniciativë.
- Një... art i Don Judd.
- U kompozua nga Rachmaninov.
- Diku në qendër.
- Një është për të lidhur.
- Jepet për hartim.
- Sergej, poet i famshëm rus.
- Veriu pa kufij.


- Mbyllin një tender.
- Një pjesë analogjisë.
- Mjeku pa ju.
- Nisin nga kreu.
- Një racë kombi.
- Një rapper i famshëm.
- Një pikë... vaji.
- Në fund majtas.
- Ndizen me një çetës.
- Emri i Delon
- Janë të dërguar specialë

VERETIKAL


- Eshtë edhe ai i sheqerit.
- Eshtë loj papagalli.
- Një Pop i Andy Warhol.
- Sapo fillojnë.
- Qendër në Kubë.
- Eshtë pluhuri si Dash.
- Eshtë e hollë dhe therëse.
- Fillojnë muzikën.
- Një kontinent i ri.
- Eshtë për medaljen e parë.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj per-seve.
- Provinca e boerëve.
- Eshtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
- Eshtë dukuria.
- Eshtë hidrokarbur.
- Griffith aktore.
- Qe perëndesha e fitores.
- Mbeten në fund.
- Tregon çmimin.
- Këndohet në opera.
- Para Fe në New Mexico.
- Eshtë princ arab.
- Tony që këndon Quando, quando, quando.
- Bën mëza.
- Pak tolerante.
- Modem pa zë.
- Pak marramendëse.
- Mbyllin një dyqan.
- Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		5	9			4	7	6	
	2		5	7					
					8				
		2			6		1	7	
5					9	3		2	
					1			4	
						5			
			6	4		9			
8	9	3							

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	4	6	5	9	2	8	1	7
9	5	8	4	7	1	2	3	6
1	7	2	6	8	3	4	9	5
4	1	9	7	2	6	5	8	3
7	2	3	8	1	5	6	4	9
8	6	5	3	4	9	7	2	1
5	8	4	9	3	7	1	6	2
2	3	7	1	6	4	9	5	8
6	9	1	2	5	8	3	7	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Ne jemi të gjithë në teatrin e jetës ... nëse qëndrojmë spektatorë, do të paguajmë! Nëse marrim pjesë në teatër, do të paguhemi.

- Duart që ndihmojnë janë shumë më të mira se buzët që luten.

- Ajo që kam arritur me filozofinë, është të bëj me dëshirën time, atë që të tjerët bëjnë sepse kanë frikë ligjet.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	1	9	2	10	19	6	5	4	5	3	19	B	A	S	T	E	T	P	A	P	A	
6	4	1	3		11				3	T	R	18	U	R	A	T	U	R	H	P	A	
13		4		3	2	4	3	2	4	5	3	S	A	M	M	A	R	A	I	N	I	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3	18		T	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
13	5	11	6	4	5	10	3	5	3	14	4	P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	
19										2	3	2	G	J	I	G	A	N	T	I	I	R
7	4	6	14	5		2			1	11	5	B	E	T	O	N	E	K	B	O	A	
8	11	1	6	11	14		4	2	18	11		S	A	L	I	R	A	M	A	E		
3	2	10	3	2	11	6		18	4	4	2	G	O	N	T	I	T	U	L	L	A	
18	8		4		5	7	6	14	6		3	5	A	R	E	S	A	O	E	N	E	
15	2	3	2	11		2	11	6	5	10	5	3	Z	J	A	R	Z	O	T	I	M	E
5	3	2	14	2	3		7	2	3	5	3	6	I	A	M	E	R	E	N	G	U	E

- Prindërit mund të japin këshilla të mira dhe të tregojnë rrugën e drejtë, por në finale formimi i karakterit të një personi qëndron në duart e veta
- Banker: Ai që ju jep ombrellën e tij kur
- koha është me diell, dhe ua merr atë
- mbrrapa, kur fillon të bjerë shi.
- - Një i mençur në mesin e të paditurve,
- është si një vajzë e bukur në mes të të
- verbërve.

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!